



INSTITUTI KOSOVAR PËR KËRKIME DHE ZHVILLIME TË POLITIKAVE

# POLITIKAT LOKALE NË KOMUNITETET MULTIETNIKE



**SOROS**  
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur  
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo  
Kosovo Foundation for Open Society

Prishtinë, Shtator 2009

Ky projekt është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur – SOROS,  
dhe nga Instituti për Qeverisjen Lokale (IQL)

Përgatitja: Genc Krasniqi  
Redaktimi: Mentor Agani

Copyright © 2009, KIPRED. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk bën të riprodhohet, të vendoset në ndonjë sistem rikthyes, apo të bartet, në çfarëdo qoftë forme apo përmes çfarëdo qoftë mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetërfare, pa lejen paraprake në shkrim të botuesit. Ju lutemi, kontaktoni [info@kipred.net](mailto:info@kipred.net), apo në +381 38 227 778.

Botuar nga:



Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave  
Kodra e Diellit, Rexhep Mala, nr 5a  
Prishtinë, Kosovë  
Telefoni dhe Telefaksi: +381 38 227 778  
[www.kipred.net](http://www.kipred.net)

## **PËRMBAJTJA**

Parathënie .....	4
Analiza Krahasuese e Politikave Lokale në Komunitetet Multietnike .....	6
Politikat Lokale në Komunitetet Multietnike – <b>Rasti Studimor: Obiliqi</b> .....	23
Politikat Lokale në Komunitetet Multietnike – <b>Rasti Studimor: Gjilani</b> .....	43
Politikat Lokale në Komunitetet Multietnike – <b>Rasti Studimor: Prizreni</b> .....	61

## PARATHËNIE

Komunat janë vendi më i mirë për përmirësimin e marrëdhënieve midis komuniteteve, dhe këto, po ashtu, mund të shërbejnë edhe si treguesi më i mirë i vullnetit të mirëfilltë për përfshirjen e komuniteteve në jetën shoqërore. Përvoja në fushën e funksionimit të komuniteteve multietnike jo vetëm që e tregon atë që pozita e pakicave në komunitetet lokale është e strukturuar në kuadrin e një kornize formale juridike, apo, madje, edhe në kuadrin e një shumësie të institucioneve për mbrojtjen e të drejtave të popullatës, por, po ashtu, edhe atë që të metat në këtë kornizë, apo në këtë strukturë institucionale, mund t'i hapin rrugë mosbesimit midis komuniteteve.

Me qëllim të kuptimit të sfidave dhe të pengesave me të cilat përballen komunat, kur çështja të vie te politikat, KHCS Nëna Terezë në Prishtinë, në partneritet me Qendrën për Rajonalizëm të Novi Sadit dhe me KIPRED-in, si partner hulumtues, të përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS), e kanë përpiluar një program shumënivelësh për analizimin e politikave lokale për komunitetet në komunat multietnike të Obiliqit, Gjilanit dhe Prizrenit.

Metodologjia e shfrytëzuar në këtë hulumtim është përpiluar ashtu që të arrihet deri te informatat e brendshme rreth situatës aktuale, lidhur me fushat të cilat e kanë ndikimin më të madh në jetën e përditshme të pjesëtarëve të grupeve etnike që nuk janë në shumicë. Metodologjia e përdorur përbëhet nga një varg intervistash me palët lokale të ndërlidhura me çështjet në fjalë, domethënë, pjesëtarë të komuniteteve, si dhe nga hulumtimi sekondar.

# **ANALIZA KRAHASUESE E POLITIKAVE LOKALE NË KOMUNITET MULTIETNIKE**

## HYRJJE

Me Shpalljen e Pavarësisë, më 17 shkurt 2008, institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës iu përkushtuan ligjërisht dhe politikisht jetësimit të Planit të Ahtisaarit (Propozimi Gjithëpërfshirës për Statusin – PGJS). Duke u mbështetur në dispozitat e Planit të Ahtisaarit, Kuvendi i Kosovës përvetësoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> e cila hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Kushtetuta i parasheh standardet më të larta për mbrojtje të komuniteteve pakicë. Edhe përkundrajt faktit që Kosova nuk ka ratifikuar ndonjë traktat lidhur me mbrojtjen e të drejtave njerëzore, apo të të drejtave sociale, politike dhe të pakicave, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parasheh vetëzbatueshmërinë e konventave, kartave dhe të instrumenteve të tjera ligjore më të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat ofrojnë mbrojtje ligjore të komuniteteve pakicë sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe evropiane.<sup>2</sup>

Kuvendi i Kosovës, po ashtu, i përvetësoi Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Mbrojtjen dhe Përparimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë, dhe Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve, të cilat hynë në fuqi më 16 qershor 2008, dhe e rregullojnë mbrojtjen e komuniteteve pakicë në nivelin kombëtar dhe atë komunal. Këto ligje e zëvendësuan legjislacionin e UNMIK-ut, dhe ofrojnë një mbrojtje të përparuar të komuniteteve pakicë në të gjitha nivelet. Po ashtu, komunat e Kosovës janë obliguar të kalojnë legjislacion komunal i cili do ta rregullojë mbrojtjen e komuniteteve brenda territorit të tyre në pajtim me legjislacionin kombëtar.

Komunat të cilat më tepër se 10% të qytetarëve të vet i kanë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, korniza ligjore e Kosovës i konsideron si komuna etnikisht të përziera, dhe në to komuniteteve u jipen mekanizma vendimmarrës shtesë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe të pozitës së tyre. Komunat e analizuara, të Obiliqit, Gjilanit dhe të Prizrenit, i takojnë pikërisht kësaj kategorie të komunave.

Qëllim i këtij punimi është analizimi i politikave lokale për komunitetet në këto komuna me qëllim të kontrollimit të zbatimit të legjislacionit, të identifikimit të problemeve në formulimin dhe në zbatimin e politikave për komunitetet, në përcaktimin e mësimëve të nxjerra, dhe në ofrimin e rekomandimeve për autoritetet kombëtare dhe lokale për përmirësimin e politikave dhe të kushteve të komuniteteve që nuk janë në shumicë në nivelin komunal.

---

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

<http://www.assemblykosova.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>

<sup>2</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe Protokolet e saj; Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolet e saj; Konventa e Kornizës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Dënimeve të Tjera Mizore, Johumane dhe Degraduese.

## **KORNIZA LIGJORE NË NIVELIN KOMBËTAR**

Instrumentet kryesore ligjore që e rregullojnë funksionimin e komunave të Kosovës lidhur me çështjet e komuniteteve janë katër, dhe këto janë Kushtetuta e Kosovës, dhe tri ligje të veçanta: Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë, dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve.

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

Dispozitat më të rëndësishme kushtetutare që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në garantimin e komuniteteve në nivelin komunal janë:

- **Përdorimi zyrtar i gjuhës** që i specifikon si gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës shqipen dhe serbishten, ndërkaq gjuhët turqishte, boshnjakishte dhe rome e kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivelin komunal (Neni 5).
- **Të Drejtat dhe Liritë Themelore** (Nenet 21 – 56), të cilat e përcaktojnë zbatueshmërinë dhe parësinë në Kosovë të të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet më të përparuara ndërkombëtare..<sup>3</sup>
- **Të Drejtat e Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre**, që e rregullojnë përgjegjësinë e shtetit për t'i mbrojtur të drejtat e komuniteteve dhe përfaqësimin e tyre në institucionet publike si dhe në qeverisjen lokale.

Dispozitat e tjera të Kushtetutës që i rregullojnë çështjet relevante për komunitetet në nivelin komunal janë: barazia para ligjit (Neni 3, dhe 5), trashëgimia kulturore dhe fetare (Neni 9), qeverisja lokale (Neni 12), shërbimi civil (Neni 101), dhe refugjatët dhe kthimi (Neni 156).

### **Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale**

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040), i shpallur nga Presidenti i Kosovës më 16 qershor 2008, e përcakton dhe e rregullon funksionimin e komunave në Kosovë.<sup>4</sup> Lidhur me të drejtat e komuniteteve dhe me pjesëmarrjen e tyre në qeverisjen lokale, ligji i specifikon instrumentet vijuese institucionale dhe ligjore:

---

<sup>3</sup> Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore dhe Protokolet e saj; Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokolet e saj; Konventa e Kornizës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Dënimeve të Tjera Mizore, Johumane dhe Degraduese.

<sup>4</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale (në versionin anglisht: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L040\\_en.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf)).

- **Komiteti për Komunitete** – është i mandatuar me status të komitetit të përhershëm (Neni 51.1). Anëtarësia e Komitetit për Komunitete e parasheh përfshirjen e anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe të përfaqësuesve të komunitetit, duke e garantuar përfaqësimin e çdo komuniteti me të paktën një përfaqësues/anëtar. Komiteti për Komunitete është përgjegjës për ta shqyrtuar pajtueshmërinë e autoriteteve komunale me ligjet në zbatim dhe për t'i shqyrtuar të gjitha politikat, praktikat dhe aktivitetet që kanë për qëllim të sigurojnë se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen në tërësi. Komitetet për Komunitete kanë të drejtë t'i rekomandojnë Kuvendit Komunal masat që i konsiderojnë të duhura për ta siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojat e komuniteteve për t'i promovuar, shprehur, ruajtur dhe zhvilluar identitetet e tyre etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore, si dhe për ta siguruar mbrojtjen e duhur të komuniteteve brenda komunës.
- **Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete** (Nenet 54-55) – është post që zbatohet në komunat me strukturë të përzier etnike. Kuvendi Komunal nga mesi i anëtarëve të vet e zgjedh Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin. Në komunat ku të paktën 10% të qytetarëve i takojnë komuniteteve që nuk janë në shumicë në komunë, pozita e Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete është e rezervuar për përfaqësuesit e këtyre komuniteteve. Ky post parashihet të mbahet nga kandidati i komunitetit që nuk është shumicë i cili e ka fituar shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për Kuvendin Komunal. Zëvendës Kryesuesi për Komunitete e ka një brez të gjerë instrumentesh në dispozicion për përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të komuniteteve të garantuara me Kushtetutë dhe me Ligjet e Republikës së Kosovës.<sup>5</sup>
- **Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete** – ky post parashihet për komunat në të cilat të paktën 10% të qytetarëve i takojnë komuniteteve jo-shumicë. Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete emërohet në bazë të propozimit të Kryetarit të Komunës dhe duhet ta marrë miratimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit Komunal të pranishëm që votojnë, dhe të shumicës së anëtarëve të Kuvendit Komunal të pranishëm që votojnë të cilët ju përkasin komuniteteve jo-shumicë. Kryetari i Komunës duhet ta konsultojë Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete rreth çështjeve që kanë të bëjnë me

---

5 Këto instrumente përfshijnë: (1) promovimin e dialogut ndër-komunitar dhe shërbimin si pikë qendrore për adresimin e brengave dhe të interesave të komuniteteve në takimet e Kuvendit dhe në veprimin e tij; (2) përgjegjësinë për shqyrtimin e kërkesave të komuniteteve apo të pjesëtarëve të tyre që aktet apo vendimet e Kuvendit Komunal i shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë; (3) referimin te Kuvendi Komunal i çështjeve të tilla si rishqyrtimi i aktit apo i vendimit; dhe: (4) kur Kuvendi Komunal vendos të mos e shqyrtojë aktin apo vendimin e vet, apo kur Zëvendës Kryesuesi i Komunës për Komunitete konsideron që madje edhe pas rishqyrtimit, akti apo vendimi paraqesin shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, Zëvendës Kryesuesi mund t'ia dorëzojë çështjen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do ta pranojë këtë për shqyrtim.



komunitetet jo-shumicë, ndërsa Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete duhet ta ndihmojë Kryetarin e Komunës dhe t'i ofrojë atij/asaj këshilla dhe udhëzime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet jo-shumicë.

### **Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë**

Ky ligj, i dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 16 qershor 2008, i jep dispozitat ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në të gjitha nivelet. Dispozitat e këtij ligji që kanë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë në nivelin komunal janë:

- **Komuniteti:** Duke u bazuar në Nenin 1.4 të këtij Ligji, komuniteti përkufizohet si grup kombëtar, etnik, kulturor, lingvistik apo fetar që tradicionalisht është i pranishëm në Republikën e Kosovës dhe që nuk është në shumicë. Kësisoj, komunitete janë serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptasit, goranët dhe komunitete të tjera. Shqiptarët i gëzojnë po ashtu të drejtat e specifikuar në këtë ligj, në komunat ku ata nuk janë në shumicë.
- **Të drejtat:** Komunitetet kanë të drejtë (Neni 2.1) t'i ruajnë, shprehin dhe zhvillojnë lirshëm kulturën dhe identitetin e tyre, dhe elementet e tyre thelbësore – fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore. Kjo e përfshin ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut të radhitura në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve në edukimin publik në të gjitha nivelet, në gjuhën zyrtare që e zgjedhin vetë, është e specifikuar në Nenin 8.1. Pjesëtarët e komunitetit e kanë të drejtën në edukimin publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre, madje edhe nëse kjo nuk është gjuhë zyrtare. Kur, brenda komunës, numri i nxënësve që i takojnë një komuniteti nuk është i mjaftueshëm për ta mundësuar procesin edukativ, Qeveria e Kosovës është e obliguar për të ofruar alternativa (transportin e subvencionuar në një zonë ku ofrohet një shkollim i tillë, mësimi në distancë, arranzhimet me mësimdhënës udhëtues, apo ofrimi i konvikteve).
- **Shkrimi origjinal:** Pos kësaj (Neni 2.4), emrat personal të pjesëtarëve të komuniteteve njihen në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin origjinal të gjuhës së tyre.. Emrat familjarë dhe emrat e fëmijëve të pjesëtarëve të komuniteteve zgjedhen lirshëm dhe hyjnë si të tillë në regjistrat publik, në identifikimin personal dhe në dokumentet e tjera zyrtare në gjuhën dhe në shkrimin e komunitetit.
- **Masat afirmative:** Neni 3.4 e përcakton që Republika e Kosovës duhet ta promovojë, përmes masave afirmative, barazinë e plotë dhe të efektshme të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe

kulturore, përfshirë edukimin, mediumet, përkujdesin shëndetësor dhe shërbimet e tjera publike.

- **Pjesëmarrja politike:** Neni 11.2 i thekson garancat për pjesëmarrje politike përmes Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, përfshirë edhe themelimin e posteve të Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete dhe të Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete.

### **Ligji për Përdorimin e Gjuhëve**

Ky Ligj është dekretuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 16 qershor 2008, dhe i jep dispozitat ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në fushën e përdorimit të gjuhëve të tyre amtare. Dispozitat e këtij ligji që e kanë një zbatueshmëri të drejtpërdrejtë në nivelin komunal janë:

- **Gjuhët Zyrtare në Kosovë:** Statusi i barabartë i shqipes dhe i serbishtes, njësoj si dhe i alfabetëve të tyre, si gjuhë zyrtare të Kosovës, dhe të drejtat e barabarta për përdorimin e tyre në të gjitha institucionet në Kosovë, janë të përcaktuara në Nenet 1.1 dhe 1.2 të këtij Ligji.
- **Gjuhët Zyrtare në Komunë:** Neni 2.3 e përkufizon gjuhën zyrtare në komunë – gjuhën e komunitetit e cila nuk është zyrtare, kur ky komunitet e përbën të paktën 5% të popullatës së komunës – njësoj si dhe përdorimin e barabartë me gjuhët zyrtare. Ky Nen e përcakton po ashtu që në Komunën e Prizrenit, turqishtja e ka statusin e gjuhës zyrtare në Komunë. Kur një komunitet brenda komunës e paraqet mbi 3% të popullatës së saj, dhe gjuha e tij nuk është gjuhë zyrtare, në bazë të Nenit 2.4, kjo gjuhë e ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në Komunë. I njëjti Nen ia jep të njëjtin status, të gjuhës në përdorim zyrtar në komunë, gjuhëve të komuniteteve të cilat janë folur tradicionalisht në një komunë. (Neni 35 e specifikon që komunat duhet të përvetësojnë rregullore të hollësishme lidhur me këtë çështje.)
- **Barazia e gjuhëve:** Nenet 7.1 – 7.4 të Ligjit e caktojnë barazinë e gjuhëve zyrtare të komunës në institucionet komunale, në komunikim, si dhe në ofrimin e shërbimeve dhe të dokumenteve publike, në cilëndo nga gjuhët zyrtare. Çdo person mund të komunikojë dhe t'i marrë të gjitha shërbimet dhe dokumentet, nga çdo institucion apo organ komunal, në çdo gjuhë zyrtare. Barazia e gjuhëve zyrtare vlen për takimet dhe punimet e të gjithë trupave komunalë. Kur të kërkohet, interpretimi nga njëra gjuhë zyrtare në tjetrën është i detyrueshëm për të gjitha takimet e të gjithë trupave komunalë. Regjistrimet, regjistrat publikë, dhe dokumentet e tjerë zyrtarë, mbahen dhe lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare. Për më tepër, Neni 8.4 e specifikon që madje edhe gjuhët që nuk janë zyrtare në komunë, mund të përdoren lirshëm nga pjesëtarët e komuniteteve përkatëse në punën dhe në takimet komunale, dhe që pajisjet për përkthim duhet të vihen në

dispozicion sa herë që të kërkohet. Dokumentet e dorëzuara nga pjesëtarët e tillë do të përkthehen në gjuhët zyrtare, dhe përgjigjet do të jipen në gjuhën origjinale. Nenet 9.1 dhe 9.2 e përcaktojnë që emrat dhe shenjat zyrtare të institucioneve komunale duhet të paraqiten në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët zyrtare të komunës.

- **Barazia e gjuhëve në Ndërmarrjet në Pronësi Publike dhe Shoqërore:** Nenet 11.1. – 11.3 e përcaktojnë që barazia e gjuhëve zyrtare vlen edhe për Ndërmarrjet në Pronësi Publike dhe në Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore. Kjo e përfshin të drejtën për të komunikuar dhe për të marrë shërbime dhe dokumente nga këto ndërmarrje në çdonjërin nga gjuhët zyrtare. Detyra për ta siguruar këtë të drejtë i takon Ndërmarrjeve në Pronësi Publike dhe Shoqërore.
- **Gjuhët në edukim; Emrat:** Kur një person e zgjedh një gjuhë zyrtare e cila nuk përdoret nga asnjë shkollë në komunë si gjuhë e mësimdhënies, në bazë të Nenit 19.4, mësimi i duhur në gjuhën e zgjedhur zyrtare sigurohet përmes një dispozite të veçantë. MASHT-i duhet t'i përcaktojë hollësitë e zbatimit. Personat që i takojnë komuniteteve gjuhët e të cilave nuk janë zyrtare (Neni 20.1), e kanë të drejtën për ta patur mësimdhënien në gjuhën e tyre në arsimimin në shkolla publike. Këta persona e kanë po ashtu të drejtën (Neni 27.2) për shënim në regjistrat publik, njësoj si dhe në identifikimin personal dhe në dokumentat e tjera zyrtare, të emrave dhe të mbiemrave të tyre në trajtën origjinale, dhe në shkrimin dhe sipas traditës së sistemit të tyre linguistik, në gjuhën e tyre.
- **Komisioni për Gjuhët; Mbikëqyrja dhe zbatimi i Ligjit:** Duke u bazuar në Nenin 32.1, për ruajtjen, promovimin dhe mbrojtjen e gjuhëve zyrtare, dhe të statusit të tyre të barabartë në Kosovë, si dhe për mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve të cilat nuk janë zyrtare, Qeveria e Kosovës do ta themelojë Komisionin për Gjuhët për ta mbikëqyrur jetësimin e këtij Ligji. (Ky Komision për Gjuhët tashmë është themeluar nga Qeveria e Kosovës, por ende nuk është funksional.)

## **LEGJISLACIONI KOMUNAL PËR KOMUNITETET**

Komunat e Obiliqit, Gjilanit dhe Prizrenit e kanë kaluar legjislacionin e kërkuar komunal të bazuar në legjislacionin e tashëm të zbatueshëm kombëtar. Në këto komuna, dispozitat që e rregullojnë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit janë të parapara me statutet komunale dhe me rregulloret për përdorimin e gjuhës në nivelin komunal. Megjithatë, janë vërejtur dy mospërputhje të legjislacionit komunal me atë kombëtar, një në Komunën e Obiliqit dhe tjetra në Komunën e Prizrenit.

Statuti i Komunës së Obiliqit është në mospërputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale sa i përket procedurave për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete. Ndërkaq, Rregullorja për Përdorimin e Gjuhëve të Komunës së Prizrenit, ndërkohë që e njëj barazinë e gjuhëve zyrtare në komunë – gjë kjo e cila është në përputhje të plotë me Ligjin – nuk e përmend edhe barazinë e gjuhëve që nuk janë zyrtare në komunë me ato zyrtaret, një barazi kjo e cila është po ashtu e garantuar me ligj.

## **INSTITUCIONET KOMUNALE PËR KOMUNITETET**

Ashtu siç u vërejt më sipër, sipas kornizës kombëtare dhe komunale, për komunitetet pakicë, në nivelin e ekzekutivit komunal dhe të kuvendit, janë të parapara institucionet/postet në vijim: Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete, Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete dhe Komiteti i Kuvendit për Komunitete, i cili e ka statusin e komitetit të përhershëm.

Zbatimi i kornizës ligjore për themelimin e institucioneve të kuvendit komunal për komunitete nuk është bërë në Komunën e Obiliqit. Komuna nuk e ka zgjedhur Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit Komunal për Komunitete. Komitetet e Kuvendit për Komunitete janë themeluar në të trija komunat, por ato janë më aktive në Komunën e Gjilanit dhe të Prizrenit se në Komunën e Obiliqit. Në gjysmën e parë të vitit 2009, Komiteti për Komunitete i Komunës së Obiliqit i ka mbajtur dy takime, ai i Komunës së Gjilanit gjashtë, dhe ai i Komunës së Prizrenit pesë. Tabela në vijim e përmbledh jetësimin e kornizës ligjore kombëtare dhe komunale sa i përket institucioneve për komunitete në këto tri komuna.

Institucionet/Komuna	Obiliqi	Gjilani	Prizreni
Zëvendës Kryesuesi për Komunitete	Jo	Jo	Po
Komiteti për Komunitete (takime)	Po (2)	Po (6)	Po (5)

Korniza ligjore lidhur me themelimin dhe funksionimin e institucioneve ekzekutive komunale për komunitete nuk është jetësuar në Komunën e Gjilanit. Kjo Komunë nuk e ka zgjedhur Zëvendës Kryetarin për Komunitete. Në nivelin e Drejtorive Komunale, komunitetet pakicë janë të përfaqësuara vetëm në Komunën e Prizrenit, meqë aty ato janë pjesë e koalicionit qeverisës komunal. Përfaqësimi i komuniteteve pakicë në shërbimin civil është në pajtim të plotë me kornizën ligjore të Kosovës në të trija komunat.

Është interesante që në të trija komunat ende ekzistojnë dhe janë në veprim Zyrat Lokale për Komunitete, të cilat janë krijuar duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 në zgjedhjet e para komunale të tetorit 2000. Aktualisht, këto zyra nuk kërkohen me Ligj – por as nuk janë të ndaluara – kështu që, këto vazhdojnë të ekzistojnë dhe të funksionojnë, edhe përkundrejt faktit që pozita e tyre është e papërcaktuar.

Zyrat Lokale për Komunitete janë pjesë integrale e komunës dhe e strukturës administrative komunale, dhe Kreu i Zyres për Komunitete është një ex-officio anëtar i Bordit të Drejtorëve të komunës. Kjo Zyre është përgjegjëse për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve, dhe për sigurimin e qasjes së barabartë të tyre në shërbimet publike në nivelin komunal. Këto Zyre, po ashtu, i mundësojnë pakicave të vogla që shqetësimet e tyre t’ua theksojnë drejtpërdrejt autoriteteve komunale, dhe këtu mendohet posaçërisht në ato ato pakica që në saje të numrit të tyre shumë të vogël nuk mund të përfaqësohen drejtpërdrejtë në kuvendin komunal dhe në ekzekutiv.

Institucionet/Komuna	Obiliqi	Gjilani	Prizreni
Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete	Po	Po	Po
Drejtoritë	Jo	Jo	Po
Zyrat Lokale për Komunitete	Po	Po	Po
Përqindja e përfaqësimit në shërbimin civil	19,1%	13,99%	18,12%

## **POLITIKAT LOKALE PËR KOMUNITETET**

Analiza e politikave lokale për komunitetet në komunat e Obiliqit, Gjilanit dhe Prizrenit do të përqendrohet në fushat e përfaqësimit, punësimit, edukimit dhe të përdorimit zyrtar të gjuhëve të komuniteteve, të cilat e kanë ndikimin më të madh në jetën e përditshme të komuniteteve.

### **Përfaqësimi**

Studimet komunale tregojnë që autoritetet qeveritare në të trija komunat e kanë siguruar jetësimin e plotë apo të pjesshëm të përfaqësimit të komuniteteve në trupat qeveritarë komunalë, dhe përfaqësimin e plotë të komuniteteve pakicë në shërbimin civil. Studimi

po ashtu hedh dritë në faktin që përfaqësimi efektiv i komuniteteve pakicë në proceset politike dhe në ato të vendim-marrjes kërkon që ato të organizohen politikisht dhe të marrin pjesë në zgjedhjet komunale.

Edhe përkundrejt faktit që legjislacioni kombëtar dhe komunal ofron mekanizma për përfaqësimin e komuniteteve pakicë në nivelin e kuvendeve dhe të ekzekutivit komunal, legjitimiteti politik i zyrtarëve të emëruar/zgjedhur të komuniteteve pakicë është një element vendimtar për ndërtimin e marrëdhënieve kredibile me pjesëtarët e komuniteteve dhe për adresimin e brengave të tyre.

Ashtu siç e tregon rasti i Prizrenit, organizimi politik dhe pjesëmarrja aktive e komuniteteve në proceset politike atyre u mundëson të bëhen pjesë e koalicioneve qeveritare komunale dhe të kenë një fjalë të fuqishme në vendimet komunale dhe në proceset e bërjes së politikave. Nga ana tjetër, rastet e Gjilanit dhe të Obiliqit tregojnë që mospjesëmarrja e komuniteteve pakicë, dhe në veçanti e komunitetit serb, në proceset politike, ato i pamundëson që ta kenë një zë të fuqishëm dhe kredibël në kuadër të qeverisjes komunale.

Komuna	Obiliqi	Gjilani	Prizreni
Këshilltarë të zgjedhur në kuvend nga komunitetet pakicë	Jo	Jo	Po (7)
Pjesëmarrja në Zgjedhjet Komunale e komunitetit më të madh pakicë	Në masë të madhe të bojkotuar nga komuniteti serb	Në masë të madhe të bojkotuar nga komuniteti serb	Shkallë e lartë e pjesëmarrjes së komuniteteve boshnjake dhe turke

Në rast të heqjes së Zyrave Lokale për Komunitete, të cilat nuk parashihen me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, lidhjet midis autoriteteve komunale dhe komuniteteve pakicë mund të dobësohen, nëse jo edhe të zhduken fare. Këto lidhje e kanë një rëndësi ekzistenciale për grupet e komuniteteve të cenueshme në komuna, si për shembull komunitetet RAE në të trija komunat, dhe të komunitetit serb në Komunën e Prizrenit.

## Punësimi në institucionet publike

Punësimi i komuniteteve pakicë në institucionet e qeverisjes komunale dhe në shërbimin civil të Obiliqit, Gjilanit dhe të Prizrenit është jetësuar në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin kombëtar dhe komunal. Ashtu siç është përmendur më sipër, përqindja e përfaqësimit të komuniteteve pakicë në Komunën e Obiliqit është 19,1%, në Komunën e Gjilanit është 13,99 %, dhe në Komunën e Prizrenit është 18,22%. Në të trija komunat, përfaqësimi i komuniteteve pakicë në shërbimin civil është më i lartë se përqindja e pjesëtarëve të tyre në nivelet përkatëse komunale.

Në rastin e kompanive në pronësi publike, gjendja e punësimit të komuniteteve pakicë është mjaft e ndryshme me atë në institucionet qeveritare komunale. Ndërmarrjeve në pronësi publike ju mungojnë strategjitë për sigurimin e përfaqësimit të barabartë të komuniteteve në personelin e tyre, duke e arsytuar këtë fakt me pohimin që politikat e tyre nuk lejojnë diskriminim profesional.<sup>6</sup> Situata lidhur me përfaqësimin e komuniteteve pakicë në ndërmarrjet në pronësi publike është e ilustruar më së miri përmes rasteve të Post Telekomit të Kosovës dhe të Korporatës Energjetike të Kosovës, si dy kompanitë më të mëdha publike në Kosovë.

Post-Telekomi i Kosovës (PTK) e ka një numër të tërësishëm prej 2.766 të punësuarish, nga të cilët 2.646 (95,66%) janë shqiptarë dhe 120 (4,34%) janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, ku 45 (1,63%) janë serbë, 32 (1,16%) janë turq, 29 (1,05%) boshnjakë, 11 (0,4%) romë, 1 (0,04%) ashkali dhe 2 (0,07%) janë të grupuar në kategorinë ‘të tjerë.’ Për PTKnë, pengesa kryesore për ta arritur përfaqësimin e barabartë të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në kuadër të institucionit të tyre është numri i vogël i aplikuesve për vende të punës, madje edhe pse ky institucioni gjithnjë i inkurajon pjesëtarët e komuniteteve të aplikojnë.<sup>7</sup>

Numri i tërësishëm i të punësuarve në Korporatën Energjetike të Kosovës – KEK (në suaza të Kosovës) është 8.241 dhe nga ky numër, 8.126 të punësuar (98,65%) janë shqiptarë të Kosovës, dhe 109 (1,35%) janë nga komunitetet pakicë – 31 (0,38%) janë boshnjakë, 28 (0,35%) janë serbë të Kosovës, 28 (0,35%) janë turq, 3 (0,04%) janë romë, dhe 19 (0,23%) janë të grupuar në kategorinë ‘të tjerë.’<sup>8</sup>

Sa i përket mundësive për punësim në kompanitë publike, romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit janë në pozitën më të keqe, meqë ata kryesisht e kanë vetëm arsimimin fillor

---

<sup>6</sup> Intervistë me z. Srđan Sentić, Kreu i Zyres për Komunitete, Zyra e Kryeministrit të Kosovës, gusht 2009.

<sup>7</sup> Ibid.

<sup>8</sup> Ibid.

dhe janë në një pozitë ku punën e gjejnë tejet vështirë. Ata për këtë ia lënë fajin jo vetëm kualifikimit të tyre të dobët, por, po ashtu, edhe diskriminimit të pretenduar, duke pohuar që punë të caktuara, si pastrues, vozitës dhe rojtarë, nuk kërkojnë arsimim të mesëm.

Pos mundësisë së punësimit në kuadër të sektorit publik të Kosovës, pjesëtarët e komunitetit serb në komunat e Obiliqit, Gjilanit dhe të Prizrenit janë po ashtu të punësuar në kuadër të komunave paralele (të vendosura në Plemetin, në Kushce të Epërme dhe në Shtërpçë), dhe në strukturat e Qeverisë së Serbisë në këto lokalitete. Një numër i tyre, posaçërisht në fushën e shëndetësisë dhe të edukimit, marrin rroga edhe nga Qeveria e Kosovës.

## **Edukimi**

Legjislacioni i zbatuar në Kosovë jep të drejta gjithëpërfshirëse dhe të veçanta edukative për komunitetet jo-shumicë (Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre në Kosovë, i shpallur më 16 qershor 2008). Këto e përfshijnë të drejtën për të fituar edukim publik në të gjitha nivelet dhe në çdonjërin nga gjuhët zyrtare (shqip dhe serbisht). Në zonat e banuara nga komunitetet gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit që u takojnë këtyre komuniteteve e kanë të drejtën për edukim parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre amtare.

Aty ku, në saje të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve, apo për çfarëdo arsye tjetër, edukimi në gjuhën e zgjedhur zyrtare apo të komunitetit nuk ofrohet, duhen garantuar alternativa. Dispozitat ligjore e njohin më tutje të drejtën e komuniteteve për të krijuar ndërmarrje private edukative dhe aftësuese dhe për të krijuar module edukative rreth kulturës, historisë dhe traditave të tyre.

Kësisoj, legjislacioni i Kosovës e njeh të drejtën për të fituar edukim publik në të gjitha nivelet e gjuhës së zgjedhur zyrtare, dhe për të fituar edukim parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhët e tjera të komuniteteve tradicionale të Kosovës në ato komuna ku këto komunitete jetojnë. Për më tepër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bashkëpunim me komunat, është po ashtu përgjegjëse për t'u ofruar nxënësve tekstet shkollore adekuate "në gjuhët e tyre amtare." Që nga viti 2008, Ministria e Arsimit është duke ofruar tekste shkollore falas për fëmijët e shkollave fillore.

Në Komunat e Obiliqit, Gjilanit dhe Prizrenit, nxënësit e komunitetit serb regjistrohen në shkollat fillore dhe të mesme të mbështetura nga strukturat paralele të Serbisë. Planet dhe librat e shkollave fillore dhe të mesme janë të bazuara në planprogramet e Ministrisë së Arsimit të Republikës së Serbisë.



Mungesa e teksteve shkollore të bazuara në planprograme e ndikon seriozisht cilësinë e edukimit në gjuhën amtare në gjuhët boshnjake dhe turke. Nuk ka (për edukimin e sipërm të mesëm, klasët 10-13), apo ka fare pak (për edukimin e mesëm të ulët, klasët 6-9) libra të bazuara në planprograme që janë në dispozicion në këto gjuhë.

Shumica e nxënësve romë në komunat e Gjilanit dhe të Obiliqit shkojnë në shkollat serbe, ku serbishtja është gjuhë e mësimdhënies, ndërkaq, në komunën e Prizrenit, ata kryesisht i ndjekin edukimin në gjuhët shqipe dhe boshnjakishte. Megjithatë, asnjëra nga lëndët në cilëndo nga këto shkolla nuk mbahet në gjuhën rome. Komunitetet e egjiptasve dhe të ashkalinjëve e ndjekin edukimin në gjuhën shqipe, meqë gjuha e tyre amtare është e njëjtë. Megjithatë, ata aty nuk kanë lëndë të posaçme rreth kulturës, historisë dhe traditave të tyre.

Planprogrami kornizë i Kosovës ndahet në lëndët e përgjithshme, dhe në lëndët 'kombëtare' të veçanta për komunitetet. Këto lëndë janë gjuha, historia, arti dhe muzika. Lëndët kombëtare për turqit dhe boshnjakët e Kosovës janë zhvilluar nga ekspertët e komuniteteve përkatëse. Por, për komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, planprogramet e 'lëndëve kombëtare' nuk janë zhvilluar, duke i bërë ata të ndjejnë se zhvillimi i identitetit të tyre është i kërcënuar.

Në praktikë, përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në pozitat drejtuese të shkollave është i pamjaftueshëm. Sistemi edukativ ofron deri në një masë aftësim në gjuhën amtare për mësimdhënësit në gjuhën turke dhe boshnjake, por aftësimi në lëndët e specializuara është në dispozicion vetëm në shqip. Nuk ka aftësim të veçantë për mësimdhënësit në gjuhën rome në gjuhën e tyre. Është një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve të nën-kualifikuar në sistemin me planprograme të Kosovës, ndërkohë që numri i mësimdhënësve të gjuhës turke dhe boshnjake në disa nga shkollat është i pamjaftueshëm.

Legjislacioni i Kosovës e parasheh një qasje të barabartë në edukimin universitar, përfshirë edhe masat e veçanta për ta siguruar pranimin e kandidatëve nga të gjitha komunitetet. Komuniteti serb e ka një universitet të veçantë në gjuhën serbe që është në Mitrovicë. Nevojat e komuniteteve boshnjake dhe turke për edukim të lartë janë të plotësuara deri në një masë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Universiteti i Prishtinës ofron lëndë të gjuhëve boshnjake dhe turke në Filologjinë Turke (50 vende), të Gjuhës Boshnjake dhe të Gjuhës Turke për Mësimdhënës (35 vende për çdonjërin), të Teknologjisë Informatike në boshnjakisht (35 vende) dhe të Administrimit të Biznesit në boshnjakisht (80 vende).

## **Përdorimi zyrtar i gjuhëve të komuniteteve**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës i përkufizon gjuhët shqipe dhe serbishte si gjuhë zyrtare të vendit. Gjuhët turke, boshnjake dhe rome e kanë statusin e gjuhës zyrtare në nivelin komunal dhe do të jenë në përdorim zyrtar në të gjitha nivelet, siç është e paraparë me ligj. Nga ana tjetër, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e përcakton që në nivelin komunal, nëse një komunitet e flet një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare, dhe e përbën të paktën 5% të popullatës së komunës, kjo gjuhë mund ta fitojë statusin e gjuhës zyrtare në nivelin komunal. Po ashtu, nëse një komunitet e flet një gjuhë e cila nuk është zyrtare, dhe e përbën midis 3 dhe 5% të popullatës komunale, kjo gjuhë mund të bëhet 'gjuhë në përdorim zyrtar' në nivelin komunal.

Të tri komunat i kanë kaluar rregulloret komunale për përdorimin e gjuhës në një pajtim të përgjithshëm me legjislacionin kombëtar. Rregullorja komunale e Obiliqit për përdorimin e gjuhëve i përcakton gjuhët shqipe dhe serbishte si gjuhë zyrtare në komunë. Rregullorja komunale për Përdorimin e Gjuhëve në Gjilan i përcakton gjuhët shqipe dhe serbishte si gjuhë zyrtare, dhe gjuhën turke si gjuhë në përdorim zyrtar. Rregullorja komunale për Përdorimin e Gjuhës e Prizrenit përcakton që gjuhë zyrtare në përdorim të barabartë në të gjitha organet e administrimit komunal janë gjuhët shqipe, serbishte, boshnjakishte dhe turqishte. Në këto tri komuna gjuha rome nuk është e shpallur gjuhë në përdorim zyrtar, meqë në kuadër të territorit të tyre komuniteti rom përbën më pak se 3% të popullatës së tërë.

Jetësimi i rregulloreve komunale për përdorimin e gjuhëve kërkon personel të mjaftueshëm për përkthime në kuadër të komunave. Mirëpo, sipas Raportit të fundit rreth Funkcionimit të Komunave në Republikën e Kosovës, nga Ministria e Qeverisjes Administrative Lokale (MQLA), në Komunën e Obiliqit njësia përkthyes nuk është e themeluar, ndërkohë që këto zyra në Komunat e Gjilanit dhe të Prizrenit janë funksionale dhe i përmbushin nevojat për përkthime.<sup>9</sup>

Uebsajti komunal i Obiliqit nuk është funksional në gjuhën serbe (<http://www.komuna-obiliq.org/?cid=3,1>). Uebsajti i Komunës së Gjilanit është në tërësi funksional në serbisht, por pjesa në turqisht nuk ekziston, edhe përkundrejt faktit që gjuha turke është shpallur si gjuhë në përdorim zyrtar në këtë Komunë (<http://www.gjilani-komuna.org/>). Uebsajti komunal i Prizrenit është në tërësi funksional në të gjitha gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtar (shqip, serbisht, boshnjakisht dhe turqisht).

---

<sup>9</sup> Reporti i Funkcionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar – Qershor 2009, Prishtinë, Korrik 2009

Probleme të mëdha të vërejtura nëpër komuna ka lidhur me futjen e emrave dhe të mbiemrave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në formën dhe në shkrimin origjinal dhe në pajtim me gjuhët e tyre përkatëse në regjistrat publik. Këto probleme ndjehen nga pjesëtarët e ndikuar të komuniteteve pakicë si tendencë për asimilim, dhe, në disa raste, edhe si ofendim në baza etnike. Kjo vlen në veçanti për pjesëtarët e komuniteteve serbe, boshnjake dhe turke.

Me qëllim të sigurimit të pajtueshmërisë së autoriteteve komunale me legjislacionin kombëtar dhe komunal për gjuhët zyrtare dhe për përdorimin e gjuhëve, nevojitet një shqyrtim i zbatimit të kornizës përkatëse ligjore nga autoritetet kombëtare. Në këtë aspekt, efektshmëria dhe profesionalizmi i Komisionit për Gjuhët të Qeverisë së Kosovës dhe i udhëzimeve komunale për komunitetet pakicë, janë instrumentale për sigurimin e zbatimit të plotë të kornizës ligjore të Kosovës dhe të asaj komunale për përdorimin zyrtar të gjuhëve.

## REKOMANDIMET

### AUTORITETEVE KOMUNALE

- Pajtueshmëria e legjislacionit lokal me kornizën ligjore kombëtare
  - Komuna e Obiliqit duhet ta adresojë urgjentisht mospërputhjen e Statutit komunal me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale sa i përket dispozitave për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete;
  - Komuna e Prizrenit duhet ta adresojë urgjentisht mospërputhjen e Rregullores komunale për Përdorimin e Gjuhëve me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
  
- Kompletimi dhe funksionimi i institucioneve komunale për komunitetet
  - Komuna e Obiliqit duhet ta zgjedhë Zëvendës Kryesuesin e Kuvendit për Komunitete;
  - Komuna e Gjilanit duhet ta zgjedhë Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete;
  - Institucionet komunale për komunitete duhet ta kenë si një përqendrim të veçantë të punës së vet të sigurojnë zbatimin e kornizës kombëtare dhe komunale ligjore për komunitete;
  - Komunat duhet t'i kushtojnë një vëmendje të posaçme adresimit të nevojave të komuniteteve pakicë të cenushme, në veçanti të komuniteteve të romëve, ashkalinjëve dhe të egjiptasve;
  - Komuniteti serb duhet të inkurajohet për të marrë pjesë në zgjedhjet komunale të ardhshme, ashtu që të sigurohet përfaqësimi legjitim në trupat qeveritar komunal.
  
- Jetësimi i kornizës ligjore për përdorimin e gjuhëve
  - Komuna e Obiliqit duhet ta themelojë njësinë e gjuhës dhe t'i ndërtojë kapacitetet e saj, si dhe ta funksionalizojë pjesën e uebsajtit në gjuhën serbe;
  - Komuna e Gjilanit duhet ta sigurojë jetësimin e plotë të dispozitave ligjore për gjuhën turke si gjuhë në përdorim zyrtar dhe ta krijojë në uebsajtin e vet pjesën në gjuhën turke;
  - Institucionet komunale për komunitetet duhet ta kenë si një përqendrim të veçantë të punës së vet sigurimin e zbatimit të kornizës ligjore kombëtare dhe komunale për komunitetet;
  - Të trija komunat duhet ta sigurojnë futjen e emrave dhe të mbiemrave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në formën dhe shkrimin origjinal, në pajtim me gjuhën e tyre, në regjistrat publik;
  - Autoritetet komunale në të trija komunat duhet ta japin një numër bursash për arsimim të lartë për pjesëtarët e komuniteteve të romëve,

ashkalinjëve dhe të egjiptasve, ashtu që t'i adresojë nevojat e tyre për ruajtjen e gjuhës së tyre.

## **AUTORITETEVE KOMBËTARE DHE KOMPANIVE NË PRONËSI PUBLIKE**

- Qeveria e Kosovës duhet të sigurojë pajtueshmërinë e legjislacionit komunal me legjislacionin kombëtar dhe zbatimin e tij të plotë lidhur me themelimin e institucioneve komunale për komunitetet;
- Ministria e Pushtetit Lokal duhet ta lëshojë një rregullore administrative me qëllim që ta zgjidhë statusin e Zyrave Lokale për Komunitetet, të cilat nuk parashihen nga korniza e tashme ligjore. Zyrat Lokale për Komunitete dhe personeli i tyre duhen integruar në funksionet e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete;
- Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë duhet ta gjejë një zgjidhje për “planprogramet kombëtare”, në veçanti për komunitetet e romëve, ashkalinjëve dhe të egjiptasve;
- Komisioni Qeveritar për Gjuhët duhet të bëhet urgjentisht funksional dhe duhet ta zbatojë kornizën ligjore kombëtare dhe komunale për gjuhët zyrtare dhe për gjuhët në përdorim zyrtar;
- Ndërmarrjet në Pronësi Publike duhet t'i zhvillojnë dhe jetësojnë strategjitë për mundësitë e barabarta, për rritjen e numrit të të punësuarve që vijnë nga komunitetet pakicë.



**POLITIKAT LOKALE NË KOMUNITETET  
MULTIETNIKE**

***RASTI STUDIMOR: OBILIQI***

## HYRJE: NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I KOMUNËS

Territori i komunës së Obiliqit shtrihet në 105 km<sup>2</sup>. Kjo komunë i ka gjithsej 21 vendbanime dhe një popullatë e cila vlerësohet në rreth 30.000 banorë. Kjo shifër është një vlerësim shumë i vrazhdë, meqë regjistrimi i fundit në Kosovë është bërë më 1981,<sup>10</sup> ndërkaq, që nga ajo kohë, kanë ndodhur ndryshime shumë të mëdha demografike, posaçërisht në periudhat para, gjatë dhe pas vitit 1999.

Për ilustrimin e këtyre ndryshimeve demografike, mjafton të krahasohet popullata e vlerësuar e tashme, me atë që ka qenë sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 1981. Në vitin 1981, 50% e popullatës së Obiliqit kanë qenë shqiptarë, 40% serbë, dhe 10% kanë qenë pakica (romë, boshnjakë, etj.). Vlerësimi i tashëm i strukturës etnike tregon se janë rreth 25.000 shqiptarë të Kosovës, rreth 3.400 serbë të Kosovës, 550 romë, 300 ashkali, si dhe rreth 70 boshnjakë dhe të tjerë.

Mosha mesatare është 24 vjet, ndërkohë që kohëzgjatja e pritur e jetës është më e shkurtër se në pothuaj të gjitha vendet e tjera të Kosovës – një pasojë e logjikshme kjo e ndotjes së jashtëzakonshme që shkaktohet nga objektet dhe pajisjet shumë të vjetra të Korporatës Energjetike të Kosovës të cilat janë menjëherë aty pranë.

Mosha	Përqindja [%]
0 – 14	34,4
15 – 65	60,2
> 65	5,4

***Tabela 3. Struktura e popullatës sipas moshës<sup>11</sup>***

Pjesa më e madhe e komuniteteve jo-shqiptare në komunën e Obiliqit jeton në fshatrat Babimoc, Milloshevë, Plemetin, Caravodicë dhe në vetë qytetin e Obiliqit.

Obiliqi është një komunë relativisht e pasur me lumenj: kjo i ka tre lumenj, Llapin, Drenicën dhe Sitnicën, dhe e ka, po ashtu, edhe një sistem të zhvilluar mirë të ujitjes nga lumi i Ibrit. Në saje të sasive të mëdha të linjtit, Obiliqi është vendi ku është ndërtuar pjesa më e madhe e potencialeve energjetike të Kosovës. Kësisoj, Obiliqi është, nga njëra anë, njëra nga qendrat më të mëdha industriale në Kosovë, dhe, nga tjetra, termocentralet Kosova A dhe Kosova B janë e vetmja shpresë ekonomike e popullatës lokale.

Sa i përket institucioneve të sundimit të ligjit, Obiliqi është nën juridiksionin e Gjykatës Komonale të Prishtinës, mirëpo sa i përket punëve policore, ky e ka Stacionin e vet të pavarur komunal Policor.

<sup>10</sup> Në vitin 1981 është bërë regjistrimi i fundit në të cilin kanë marrë pjesë të gjitha grupet etnike.

<sup>11</sup> Zyra Statistikore e Kosovës, regjistrimi i vitit 1981.



## PJESËMARRJA POLITIKE

Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit përbëhet nga 21 anëtarë,<sup>12</sup> të zgjedhur në Zgjedhjet Komunale të nëntorit 2007. Aktualisht, në Kuvendin Komunal të Obiliqit nuk ka përfaqësues të serbëve të Kosovës, ndërkohë që në Kuvendin e parë ishin 7 këshilltarë serbë, gjë kjo e cila u vijua me 3 këshilltarë pas zgjedhjeve të dyta.

Serbët e Obiliqit në masën më të madhe e kanë refuzuar pjesëmarrjen në institucionet e Kosovës që nga Shpallja e Pavarësisë. Hezitimi i tyre ilustron qartë nga fakti që edhe pse 5 parti politike serbe kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2007, asnjëra nga to nuk ia doli ta arrijë kuotën e domosdoshme të paraparë me ligj për të hyrë në kuvend.

Rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2007 ia vlen të përmenden, meqë këto janë një nga shkaqet kryesore për të metat gjatë konsolidimit të organeve të kuvendit, heret në vitin 2008. Kryetari i Komunës së Obiliqit, i zgjedhur në zgjedhje për kryetar të komunës të vitit 2007,<sup>13</sup> është z. Rexhep Kelani i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Edhe përkundrejt faktit që Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka numrin më të madh të këshilltarëve në kuvend, kryetari i komunës është megjithatë nga LDK-ja, në saje të koalicionit që LDK-ja ia doli ta arrinte me AAK-në. Sidoqoftë, Komuna e Obiliqit nuk e ka patur ndonjë fitues të qartë, dhe duket se nuk e ka një koalicion të fuqishëm. Për ta arritur vendimmarrjen nevojiten marrëveshje.

Nga ana tjetër, Obiliqi është një bashkësi e vogël, ku ‘çdonjëri e një çdonjërin,’ dhe lidhjet familjare midis anëtarëve të partive kundërshtare mjaft shpesh i tejkalojnë vijat partiake. Kështu, është e vështirë, nëse jo edhe e pamundur, të parashihet se si do të shkojë funksionimi i aleancave politike në Kuvendin Komunal. Sipas një numri intervistash të zhvilluara, shumica e votave të anëtarëve të kuvendit mund të ‘blihen’ fare lehtë, dhe këto mjaft shpesh përdoren për punësimin e pjesëtarëve të familjes.

Është, po ashtu, edhe një numër i madh i grindjeve të brendshme brenda vetë partive. Kështu, për shembull, duket thuaja sikur Kryetari i Komunës nuk e ka mbështetur në plotë të këshilltarëve që vijnë nga vetë LDK-ja, kryesisht për shkak të dallimeve në pikëpamje me pararendësin e tij, i cili, më tutje, tash është bërë zëvendës ministër në qeverinë qendrore.

---

<sup>12</sup> PDK – Partia Demokratike e Kosovës (7 ulëse); LDK – Lidhja Demokratike e Kosovës (6 ulëse); AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (3 ulëse); AKR – Aleanca Kosova e Re (3 ulëse); ORA – Partia Reformiste ORA (1 ulëse); PD – Partia e Drejtësisë (1 ulëse).

<sup>13</sup> Shtatë vite pas themelimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, UNMIK-u e ka shpallur Rregulloren 2007/27 “Për Zgjedhjet Komunale në Kosovë,” e cila e ka mundësuar zgjedhjen e drejtpërdrejtë të kryetarëve të komunave.

## LEGJISLACIONI KOMUNAL

Dokumenti i vetëm zyrtar i Komunës së Obiliqit që ishte në dispozicion, pjesë të të cilit kishin të bënin me çështjen e pjesëmarrjes së komuniteteve në vetëqeverisjen lokale, ishte Statuti i Komunës.

### **Statuti i Komunës së Obiliqit**

Statuti i Komunës së Obiliqit u përvetësua në shtator 2008, mbështetur në mandatin që komunave të Kosovës ua dha Ligji për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës. Në këtë Statut ka dispozita të shumta që janë të ndërlidhura me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet në qeverisjen lokale.

Së pari, Neni 33 i Statutit e përcakton pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete. Më tutje, Neni 34 i këtij Statuti i krijon dy Komitete të Përhershme nga ana e Kuvendit Komunal të Obiliqit, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Numri i anëtarëve të Kuvendit në çdonjërin nga këto Komitete duhet të përcaktohet nga Kuvendi Komunal, dhe Kryetari i Komunës Kuvendit Komunal ia propozon anëtarët e këtyre Komiteteve të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit Komunal.

Komiteti i Komuniteteve, më tutje, përkufizohet në Nenin 40. Anëtarët e Komitetit për Komunitete i emëron Kuvendi Komunal, nga mesi i anëtarëve të Kuvendit Komunal, si dhe nga përfaqësuesit e komuniteteve pakicë. Ky Komitet duhet të ketë të paktën pesë, dhe të shumtën nëntë anëtarë. Komiteti për Komunitete përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve pakicë që jetojnë në komunë (dhe çdo komunitet e ka të paktën një përfaqësues).

Neni 59, në Kapitullin për Kryetarin e Komunës dhe Administratën Komunale, e përcakton pozitën e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete. Sipas këtij Statuti, mandati i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete në Komunën e Obiliqit është i njëjtë sikurse edhe mandati i Kryetarit të Komunës, dhe ai, me propozimin e Kryetarit të Komunës, emërohet dhe shkarkohet nga ana e Kuvendit Komunal, me miratimin e shumicës së anëtarëve të tij. Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete i ndihmon Kryetarit të Komunës me këshilla dhe udhëzime rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë. Kur pozita e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete mbetet e lirë, Kryetari i Komunës e emëron Zëvendës Kryetarin e ri të Komunës për Komunitete, jo më vonë se 30 ditë që nga momenti kur ky post ka mbetur i lirë.

Më pastaj, është, po ashtu, Neni 73, që e përcakton që punësimi në shërbimin civil mbikëqyret nga Kryesuesi i Personelit, për të siguruar që shërbimi civil të pasqyrojë përpjesë të duhur profesionale, gjinore dhe etnike.

Sa i përket përputhshmërisë midis Statutit të Komunës së Obiliqit dhe Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë në vetëqeverisjen lokale, janë dy pika që duhen theksuar. Që të dyja këto kanë të bëjnë me pozitën e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete.

Së pari, ka mungesë pajtueshmërie midis Statutit të sipërpërmendur dhe Ligjit, lidhur me procedurat e parapara për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete. Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Neni 61.3) “Emërimi dhe shkarkimi i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete do të propozohet nga Kryetari i Komunës, dhe duhet ta fitojë miratimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit komunal të pranishëm që votojnë dhe të shumicës së anëtarëve të kuvendit komunal të pranishëm që votojnë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë.” Nga ana tjetër, Neni 59.2 i Statutit të Komunës së Obiliqit nuk e parasheh shumicën e anëtarëve të kuvendit komunal të pranishëm që votojnë nga radhët e komuniteteve jo-shumicë. Ky nen i Statutit thotë: “Emërimi dhe shkarkimi i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës, dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të kuvendit komunal të pranishëm.”

Së dyti, pika 4 e Nenit 59 të Statutit përcakton që: “Kur posti i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete të mbetet i lirë, veprimi do të jetë i njëjtë si në rastin e Zëvendës Kryetarit të Komunës, i përcaktuar në Nenin 58.4” (dhe, Neni 58.4 thotë: “Kur posti i Zëvendës Kryetarit të Komunës mbetet i lirë, Kryetari i Komunës e emëron Zëvendës Kryetarin e ri të Komunës jo më vonë se 30 ditë që nga momenti kur posti ka mbetur i lirë.”) Rrjedhimisht, Pika 4 e Nenit 59 të Statutit të Komunës së Obiliqit është në kundërshtim, edhe me Pikën 2 të të njëjtit Nen 59, të të njëjtit Statut (e cila e parasheh që emërimi i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete **propozohet** nga Kryetari i Komunës, dhe **vendoset** nga Kuvendi i Komunës), dhe edhe me Nenin 51.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, i cili, në thelb, e përcakton të njëjtën, vetëm se e shton edhe nevojën për shumicën e pjesëtarëve të Kuvendit Komunal nga radha e komuniteteve.<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> Ligji për Vetëqeverisjen Lokale i parasheh dy poste të Zëvendës Kryetarëve Komunal: Zëvendës Kryetarin e Komunës, dhe Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete (ky i dyti në komunat ku më tepër se 10% e popullatës përbëhet nga komunitetet jo-shumicë). Është një dallim thelbësor midis këtyre dy posteve, që ka të bëjë me procedurat për emërimin dhe shkarkimin e të dyve. Zëvendës Kryetari i Komunës emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës, ndërkaq, Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete emërohet dhe shkarkohet me

## INSTITUCIONET KOMUNALE PËR KOMUNITETET

Për shkak të pjesëmarrjes simbolike të komunitetit serb në zgjedhjet komunale të nëntorit 2007, komuniteti më i madh pakicë në Obiliq nuk e ka ndonjë përfaqësim të zgjedhur drejtpërdrejt në Kuvendin Komunal. Sidoqoftë, Ligji për Vetëqeverisjen Komunale (Neni 54.2) e parasheh që nëse komunitetet jo-shumicë, për çfarëdo arsye, nuk e kanë ndonjë këshilltar në Kuvendin komunal, atëherë Kuvendi Komunal duhet ta zgjedh si Zëvendës Kryesues kandidatin e komunitetit jo-shumicë i cili e ka marrë numrin më të madh të votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje në Kuvendin Komunal. Megjithatë, Kuvendi Komunal i Obiliqit nuk e ka zgjedhur Zëvendës Kryesuesin për Komunitete, duke dështuar në këtë mënyrë t'i përmbushë obligimet ligjore që dalin nga korniza ligjore.

Kuvendi Komunal i Obiliqit e ka themeluar Komitetin për Komunitete më 15 prill 2008, para hyrjes në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.<sup>15</sup> Kryesues i Komitetit është zgjedhur z. Lubomir Đorđević, në konsultime të afërta me komunitetin serb. Gjatë gjysmës së parë të vitit ky Komitet i ka mbajtur dy takime.<sup>16</sup>

Në nivelin ekzekutiv komunitetet pakicë janë të përfaqësuara me pozitën e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete dhe me Kreun e Zyres Lokale për Komunitete. Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete është z. Predrag Jović, ndërkaq, Kreu i Zyres Lokale për Komunitete është z. Slaviša Adančić, që të dytë nga komuniteti serb.

Në shërbimin civil komunitetet janë të përfaqësuara në nivelin 19,1%. Nga kjo vlerë, 16,78% janë serbë, 1,5% ashkalinj, 0,44% boshnjakë, dhe romë janë 0,22%.<sup>17</sup> Komuna e Obiliqit nuk e ka të krijuar njësinë për përkthime, dhe është vetëm një përkthyes për gjuhët shqipe dhe serbishte.<sup>18</sup>

---

propozim të Kryetarit të Komunës, nga shumica e anëtarëve të Kuvendi Komunal, me miratim të shumicës së anëtarëve të Kuvendit Komunal që u takojnë komuniteteve jo-shumicë. Kjo Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete ia jep shkallën kyçe të pavarësisë dhe të mbrojtjes, që është e domosdoshme për përmbushjen e detyrave të parapara për këtë post. Janë kjo pavarësi dhe kjo mbrojtje, ato që e pësojnë nga Neni 59.4 i Statutit të Komunës së Obiliqit.

<sup>15</sup> Shih: <http://www.komuna-obiliq.org/?cid=1,10,27>.

<sup>16</sup> Raporti i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar – Qershor 2009, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Korrik 2009, f.64.

<sup>17</sup> Një detaj tejet interesant – dhe i cili, në të vërtetë, duhet përshëndetur dhe lavdëruar – lidhur me të punësuarit në shërbimin civil në Komunën e Obiliqit është ai rreth përfaqësimit gjinor. Raporti i përfaqësimit gjinor është 205 (57.49%) me 190 (42.51%) në favor të femrave, ndërkohë që përbrenda vetë kategorisë së komuniteteve pakicë, i njëjti raport është 52.94% me 47.06% në favor të femrave (në vlerë absolute, 45 me 40).

<sup>18</sup> Raporti i Funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar – Qershor, 2009, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, korrik 2009, fq. 65.

Sa i përket pjesës financiare për komunitete, 19% përqind të mjeteve financiare të komunës janë ndarë për pakica dhe për çështje të pakicave. Pos kësaj, komuna e ka siguruar transportin për të gjitha komunitetet. Po ashtu, në gjysmën e parë të vitit 2009 nuk është regjistruar asnjë rast i vetëm i shkeljes së të drejtave të komuniteteve pakicë.<sup>19</sup>

## **JETA E MIRËFILLTË**

Aspektet e jetës shoqërore në të cilat individi mund të pengohet seriozisht në përmbushjen e aspiratave të veta janë të shumta, dhe kur çështja të vie tek pjesëtarët e grupeve etnike jo-shumicë, shkallët e kësaj janë më të stërholluara. Këto aspekte shtrihen nga edukimi, përkujdesi shëndetësor dhe liritë institucionale, e deri te potencialet ekonomike për zhvillim. Disa nga tiparet më të ndjeshme të këtyre aspekteve do të përmenden ndaras, duke i dhënë grimcat për kompletimin e mozaikut.

### **Edukimi**

Në Komunën e Obiliqit, edukimi organizohet në tri nivele: si edukim parashkollor, elementar (fillor) dhe sekondar (i mesëm). Procesi arsimor është i ndarë etnikisht, me përjashtim të shkollës filllore në Caravodicë, ku nxënësit shqiptarë dhe serbë të Kosovës e shfrytëzojnë të njëjtin objekt shkollor në ndërrime të ndryshme. Janë nëntë shkolla filllore, pesë nga të cilat ofrojnë arsimim fillor në shqip, dhe katër në serbisht, dhe në komunë është po ashtu edhe shkolla e mesme me numrin prej mbi 5.500 nxënësish, e cila i përfshin edhe dy klasë të integruara të shkollës së mesme për Ekonomi dhe Mjekësi në Plemetin për nxënësit serbë të Kosovës. Kjo përbërje etnike e nxënësve është pak a shumë e njëjtë si edhe demografia e përgjithshme.

Të gjithë fëmijët serbë të komunës i ndjekin shkollat në serbisht, dhe ata janë fare mirë të vetëdijshëm për vështirësitë e gjendjes së sigurisë. Shkolla serbe në Obiliq i ka dritaret dhe dyert me grila, meqë kjo me shkollat shqipe të mesme mjekësore dhe komerciale e ka të përbashkët kopshtin. Deri më tash nuk janë raportuar incidente midis nxënësve. Nxënësit serbë nga Obiliqi e ndjekin shkollën e mesme në Plemetin, e cila ka vend për rreth 350 prej tyre. E njëjta ndërtesë shfrytëzohet edhe si shkollë filllore e fshatit.

### **Përkujdesi shëndetësor**

Qendra kryesore primare familjare e përkujdesit shëndetësor në qytetin e Obiliqit i është e përkushtuar ofrimit të shërbimeve mjekësore për të tërë popullatën e komunës, dhe kjo

---

<sup>19</sup> Ibid.

i ka pesë qendra të tjera familjare të shëndetit në vendbanimet me më tepër se 2.000 banorë. Këto vendbanime i përfshijnë Milloshevën, Plemetinin, Breznicën, Palajn dhe Sibovcin. Pos kësaj, janë edhe dy qendra të tjera më të vogla të përkuqjesit shëndetësor në fshatrat Shipitullë dhe Babimoc. Vërehet një nivel i ulët i shërbimeve të përkuqjesit shëndetësor, posaçërisht në pjesët veriore dhe jugperëndimore të komunës.

Edhe në këtë fushë ka ndarje etnike. Serbët marrin trajtime mjekësore në institucionet mjekësore serbe, të financuara nga Qeveria e Serbisë. Serbët, me disa përjashtime, në përgjithësi, nuk u besojnë mjekëve shqiptarë.

Romët e rajonit shkojnë kryesisht në institucionet mjekësore serbe, edhe pse ata e ndjejnë veten më të lirë t'i vizitojnë edhe ato shqiptare. Sa u përket ashkalinjëve, ata i parapëlqejnë objektet shqiptare. Qendrat mjekësore shqiptare paguajnë nga 1 € për një ekzaminim dhe përshkrim ilaçesh, edhe pse, shfrytëzuesit e shërbimit social janë të përjashtuar nga kjo.<sup>20</sup> Qendrat shëndetësore serbe nuk kanë kurrfarë pagesash dhe ilaçet i shpërndajnë falas. Megjithatë, ilaçet e përshkruara nuk janë në dispozicion, dhe romët ato duhet t'i blejnë në farmacitë private të shqiptarëve.

## **Zhvillimi ekonomik dhe punësimi**

Burimet kryesore të zhvillimit ekonomik të komunës së Obiliqit janë termocentralet, mihjet sipërfaqësore të qymyrit, toka e plleshme dhe rruga M2, nga Prishtina për në Mitrovicë. Potenciali kryesor zhvillimor i komunës është në minierën e qymyrit dhe në tokën e mirë bujqësore. Me dikund rreth 5.400 hektarë të tokës së plleshme, 4.500 nga të cilët janë në pronësi private, një strategji e përpiluar siç duhet për bizneset bujqësore mund të jetë një ide e mirë për sigurimin e rritjes ekonomike. Megjithatë, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me dy centralet e veta kryesore, është dhe do të mbetet edhe në një të ardhme të parashikueshme, punëdhënësi kryesor në komunën e Obiliqit.

Problemi kryesor me të cilin përballen pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë këtu edhe shqiptarët, është në mundësitë e kufizuara të punësimit. Ka patur përpjekje të shumta që i ka bërë Qeveria e Kosovës lidhur me punësimin e pjesëtarëve të pakicave në institucionet politike dhe në kompanitë publike. Mund të thuhet që, nga njëra anë, janë arritur suksese të konsiderueshme në rastet e institucioneve politike qendrore dhe lokale,<sup>21</sup> dhe që, nga tjetra, ka ende pengesa të konsiderueshme në rastin e kompanive publike.

---

<sup>20</sup> Qeveria e Kosovës i paguan të gjitha përfitimet e sigurimit shëndetësor për të gjithë ata që e kanë të drejtën në to, si dhe përfitimet sociale, përfshirë këtu edhe pensionet e moshës për ata që i kanë mbi 65 vjet.

<sup>21</sup> Dhe, në rastet në të cilat kemi përballje me vështirësi, këto vështirësi janë në masën më të madhe pasojë e shmangies së institucioneve të Kosovës nga ana e serbëve.

Komuna e Obiliqit, dhe punësimi i pjesëtarëve të pakicave në të, e ilustron këtë në një mënyrë të përsosur. Kështu, numri i tërësishëm i të punësuarve në Komunën e Obiliqit është 450: 3 të emëruar politikë, dhe 447 shërbyes civil. Ky numër i përfshin shërbyesit civil që punojnë në vetë Komunë, njësoj si dhe ata që punojnë në shërbimet lokale në tre sektorë: në edukim, përkujdesje shëndetësore, dhe në shërbimet sociale. Nga 3 të emëruarit politikë, 2 janë shqiptarë të Kosovës, dhe 1 është serb i Kosovës. Nga 447 të punësuarit në shërbimin civil (numri i tërësishëm), 362 (80,99%) janë shqiptarë të Kosovës, dhe 85 (19,01%) ju takojnë pakicave – 75 (16,78%) janë serbë të Kosovës, 7 (1,57%) janë ashkalinj, 2 (0,44%) janë boshnjakë, dhe 1 (0,22%) është rom.<sup>22</sup>

Mirëpo, ky lloj i duhur i përpjesës nuk mund të haset edhe në rastin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-ut), e cila, siç u përmend, është punësuesi kryesor në komunën e Obiliqit. Numri i tërësishëm i të punësuarve në KEK (për të tërë Kosovën) është 8.241 (6 zyrtarë të nivelit politik, që janë anëtarë të Bordit, që të gjithë shqiptarë), dhe 8.235 të punësuar të tjerë. Në mesin e tyre, 8.126 (98,65%) janë shqiptarë të Kosovës, dhe 109 (1,35%) janë nga komunitetet pakicë – 31 (0,38%) janë boshnjakë, 28 (0,35%) janë serbë të Kosovës, 28 (0,35%) janë turq, 3 (0,04%) romë, dhe 19 (0,23%) janë grupuar nën kategorinë ‘të tjerë.’<sup>23</sup>

Nga ana tjetër, në institucionet paralele të Qeverisë së Serbisë të punësuarit janë ekskluzivisht serbë, dhe këto institucione veprojnë në Obiliq, njësoj si edhe në pjesët e tjera të Kosovës. Është, po ashtu, edhe një numër tjetër i pjesëtarëve të pakicave që punojnë në bizneset private, por, në një rëndësi anë, ky numër është shumë i vogël, dhe ata janë të kufizuar nga vetë madhësia e bizneseve të tyre, meqë ata ofrojnë të mira dhe shërbime vetëm për pjesëtarët e komuniteteve të tyre, dhe nga tjetra, numri i serbëve që punojnë në bizneset që janë pronë e shqiptarëve është i papërfillshëm.

Kjo gjendje edhe ashtu e keqe sa i përket punësimin të serbëve të Kosovës, u përkeqësua jashtëzakonisht shumë pas Shpalljes së Pavarësisë, meqë një numër i madh i tyre i lanë vendet e punës në institucionet e Kosovës. Qeveria e Serbisë ushtroi trysni në serbët e Kosovës për t’i lënë vendet e punës nëpër institucionet nën juridiksionin e Qeverisë së Kosovës.

Gjatë dy javëve të para pas 17 shkurtit 2008, fare pak serbë të Kosovës shkuan në punë. Disa nga ta morën pushime pa pagesë deri në fund të marsit 2009. Një numër i serbëve filloi të kthehet nëpër vendet e tyre të punës rreth tri javë pas Shpalljes së Pavarësisë, mirëpo ngurrimi i tyre për ta bërë këtë është ende një problem i madh. Kohëve të fundit është arritur një sukses i konsiderueshëm lidhur me këtë çështje, kur oficerët serbë të

---

<sup>22</sup> Po e përsërisim edhe një herë strukturën shembullore gjinore të të punësuarve në Komunën e Obiliqit, 57.4% me 42.51% në favor të femrave (205 me 190).

<sup>23</sup> Meqë ra fjala, sa i përket balancit gjinor, në të tërë Kosovën, për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK-un), ky është 6.887 (85.2%) me 1.197 (14.8%) në favor të meshkujve.

policisë u kthyen kolektivisht në vendet e tyre të punës në Shërbimin Policor të Kosovës. Ky kthim mund t'i kontribuojë po ashtu edhe zvogëlimin të brengave të komuniteteve sa i përket çështjeve të sigurisë, meqë, sipas kornizës ligjore të Kosovës, çështjet e sigurisë janë kompetenca të institucioneve qendrore, dhe jo të atyre lokale. Momentalisht, në Stacionin Policor të Komunës së Obiliqit, janë 76 oficerë policie, nga të cilët 12 janë serbë të Kosovës.

Shumica e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve kanë vetëm shkollim fillor, dhe këta e kanë tejet të vështirë për të gjetur punë. Për këtë ata e fajësojnë jo vetëm kualifikimin e tyre të dobët, por, po ashtu, edhe diskriminimin e pretenduar, duke pohuar që vende të caktuara të punës, të tilla si pastrues, vozitës dhe rojtarë, nuk kërkojnë arsimim të mesëm. Ndërkohë që para luftës shumica e ashkalinjëve dhe e romëve punonin për shërbimet publike, sot ata nuk mund të gjejnë punë madje as edhe atje. As ashkalinjtë me diploma universitare nuk mund të gjejnë punë, dhe të njëjtat telashe i kanë edhe egjiptasit e tillë. Shumica e individëve që u takojnë këtyre pakicave janë duke kërkuar punë fizike, por punët e tilla janë të pamjaftueshme; nganjëherë, atyre u jipen punë sezonale në fushat e serbëve apo të shqiptarëve.

Që të gjithë janë të pakënaqur me përpjesën e përfaqësimit të tyre në ndërmarrjet publike. Diku rreth 90 përqind të romëve të Obiliqit, para luftës kanë punuar në termocentralin lokal. Megjithatë, kjo nuk vlen edhe më tutje.

Problemi me termocentralin është shumë më i ngatërruar se sa që mund të duket në shikim të parë. KEK-u është një ndërmarrje në pronësi publike, dhe si e tillë, bie nën jurisdikcionin e AKP-së (Agjencioni Kosovar i Privatizimit), dhe, kështu, është, pak a shumë, më i lirë nga trysnitë komunale lidhur me çështjet e punësimit. Nga ana tjetër, dyfishimi i posteve që ndodhi gjatë viteve 90', kur shqiptarët dëboheshin me të madhe nga vendet e tyre të punës, vetëm e vetëm që ato të mbusheshin nga serbë dhe të tjerë, ka krijuar probleme vigane, të cilat "u zgjodhën" në ditët e hershme pas përfundimit të Luftës së Vitit 1999, kur ndodhi po i njëjti zhvillim si edhe më parë, vetëmse tash në kahjen e kundërt.

## **PLEMETINI**

Fshati Plemetin që ndodhet në komunën e Obiliqit e paraqet një rast shumë të rëndësishëm dhe interesant. Në këtë fshat jetojnë afërsisht 1.000 qytetarë serbë dhe rreth 300-400 romë.

Serbët dhe romët që jetojnë në Plemetin, konsiderojnë që ende nuk e gëzojnë të drejtën e lëvizjes. Qytetarët lokalë jetojnë në frikë të sulmeve. Për shkak të kësaj frike, ata nuk punojnë në fermat e tyre, të cilat ndodhen larg fshatit. Ata po ashtu nuk shkojnë në lokalet dhe kafenetë në Obiliq në të cilat e kanë zakon të shkojnë shqiptarët. Po ashtu,



ndodh që kalimtarët shqiptarë nganjëherë i shajnë serbët. Sipas njërit nga të intervistuarit, çështja e transportit publik është po ashtu një nga pengesat për integrim. Nuk ka shërbim autobusësh që shkojnë në Plemetin, apo nga fshati i tyre për në Obiliq. Serbët dhe romët rëndom e shfrytëzojnë trenin midis Mitrovicës dhe Prishtinës. Treni kalon nëpër fshatin e tyre katër herë në ditë. Ata po ashtu i shfrytëzojnë taksitë që operohen nga serbët.

Qytetarët serbë dhe romë kanë qasje në të gjitha institucionet e Kosovës. Të gjitha veprimet administrative të serbëve bëhen në Obiliq, ku ato mund të kryhen në serbisht. Të gjitha dokumentet që i marrin në komunë janë në serbisht. Megjithatë, serbët që i drejtohen komunës së Obiliqit me shkrim, rrallë herë kanë marrë ndonjë përgjigje. Qytetarët romë ju drejtohen shërbyesëve dhe zyrtarëve civilë, qoftë në serbisht, qoftë në shqip.

Para Luftës, afërsisht 80% përqind të forcës punëtore të Plemetit kanë punuar në KEK, domethënë, në centralët energjetike Kosova A dhe Kosova B, si dhe në mihjet sipërfaqësore të Bellaqevcit dhe të Dobro Sellos. Shumica e këtyre punëtorëve tash i marrin nga 60 € nga Qeveria e Serbisë. Në fundin e vitit 2007, janë bërë disa përpjekje, dhe edhe një tjetër në fillimin e vitit 2008, për ta mbajtur një takim me Drejtorin e KEK-ut, njësoj si dhe me Ministrin e Energjisë. Megjithatë, ndaj këtyre nismave nuk ka patur kurrfarë përgjigje. Letrat ishin të shkruara në serbisht. E njëjta kërkesë i është dërguar edhe Qeverisë së Serbisë. Nga ajo është kërkuar që ta zgjidhë këtë problem me KEK-un në nivelin institucional.

## **TË KTHYERIT**

Një numër i madh i të kthyerve në Obiliq janë tejet të cenueshëm, vlera e pasurisë së tyre është e kufizuar, dhe ata kanë fare pak shkathtësi me të cilat mund të konkurrojnë në tregun e punës. Me qëllim të adresimit të nevojave të tyre të menjëhershme dhe të atyre në afat të mesëm, shoqëria dhe institucionet politike duhet të kërkojnë mënyra për të ofruar asistencë dhe përkrahje shoqërore-ekonomike, ashtu që ata të aftësohen për të krijuar të ardhura. Një nga shtigjet e mundshme për ta arritur këtë qëllim është që ekonomitë familjare të të kthyerve të përkrahen ekonomikisht me grante financiare, për të filluar biznese të vogla apo për të krijuar të ardhura përmes veprimtarive bujqësore, dhe/ose përmes ofrimit të trajnimeve për zhvillimin e shkathtësive të domosdoshme. Si institucionet ndërkombëtare, ashtu edhe organizatat e shoqërisë civile, edhe lokale, edhe ndërkombëtare, munden të japin po ashtu një kontribut të konsiderueshëm për përmbushjen e këtij qëllimi, dhe përpjekjet e tyre, edhe përkundrajt faktit që nuk ishin të mjaftueshme, nuk kanë munguar në tërësi.

Një faktor tejet i rëndësishëm për t'i bërë këto kthime të qëndrueshme, është forcimi i përkujdesit shëndetësor primar dhe rritja e mundësive të edukimit, si dhe zbatimi i projekteve të vogla të zhvillimit komunal në komunitetet e përziera ku ka kthime. Kjo do

ta përmirësojë mjedisin shoqëror në vendin e të kthyerve, dhe njëkohësisht do të ofrojë përfitime për të tërë komunitetin. Në kuadër të strategjisë së vet, komuna e vë theksin në integrimin e të gjitha komuniteteve etnike në Obiliq. Një nga sfidat që përsëriten për të kthyerit nga radhët e pakicave është ofrimi i shërbimeve publike dhe qasja në to, gjë kjo e cila e paraqet një të drejtë themelore të çdo popullate. Shërbimi mjekësor dhe edukimi janë në mesin e sektorëve kyç në të cilët komunitetet e përziera mund të punojnë në drejtim të krijimit të një mjedisi i cili do ta nxisë respektimin e të drejtave themelore shoqërore, dhe kësaj, edhe për një kthim të qëndrueshëm.

## **SERBËT**

Pas shqyrtimit të disave nga aspektet që e karakterizojnë gjendjen e pakicave në komunën e Obiliqit në përgjithësi, tash do të përqendrohemi në pakicat e veçanta.

Situata e pakicës serbe është e dëshpëruar. Ata veten e ndjejnë të përjashtuar nga trajtësimi i ardhmënisë së komunës, dhe, për më tepër, edhe nga trajtësimi i vetë ardhmënisë së vet. Jo vetëm që ata e pësojnë nga gjendja e pakicës, e cila është në tërësi e re për ta – duke e patur parasysh që ata kanë qenë etnia sunduese në jetën shoqërore në Obiliq për një kohë shumë të gjatë – por, për më tepër, ata po ashtu ndjehen viktimë e lojrave të shumta dhe të ndryshme të fuqisë midis bashkësisë ndërkombëtare, Serbisë dhe shqiptarëve të Kosovës.

Në një masë të madhe, perceptimi i tyre mund të jetë i saktë. Ashtu siç u përmend, ata janë në një gjendje në të cilën vetë ndikimi i tyre në vetë ardhmëninë e tyre është shumë i kufizuar. Ata, nga njëra anë, nxiten nga Serbia për ta kundërshtuar gjendjen e re e cila është në shfaqje e sipër, por, nga tjetra, ata po ashtu ndjehen të braktisur dhe e dinë se nuk janë të rëndësishëm për Serbinë në këtë lojë të fuqisë. Për serbët që jetojnë në brendi të vendit, kjo është posaçërisht e vërtetë gjatë periudhës pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, pas të cilës Qeveria e Serbisë gjithnjë e më tepër është përqendruar në pjesën veriore të Kosovës. Si pasojë e zgjedhjeve të bojkotuar, pas trysnisë së Qeverisë së Serbisë, serbët e komunës së Obiliqit gjithnjë e më shpesh janë duke ardhur në një situatë në të cilën ata nuk e kanë ndonjë përfaqësim legjitim, as para bashkësisë ndërkombëtare, as para institucioneve të Kosovës, dhe, mjaft shpesh, as para vetë komunitetit të vet.

Edhe përkundrejt faktit që serbët e gëzojnë një liri të plotë të lëvizjes në zonat ku janë shumicë, të tilla si në fshatrat Plemetin dhe Babimoc, gjendja është larg nga ajo që të jetë e përsosur. Vrasja e familjes tre-anëtarëshe Stolić, në majin e vitit 2003, përmendej ende në disa nga intervistat që i zhvilluam. Megjithatë, duhet përmendur ajo se në vitet e fundit ka ndodhur një përmirësim i konsiderueshëm sa i përket lirisë së lëvizjes, gjë kjo e cila ilustron nga fakti që, edhe përkundrejt disa incidenteve të vogla, që nga trazirat e marsit të vitit 2004, në të tërë Kosovën nuk ka ndodhur as edhe një rast i vetëm i ndonjë vrasjeje të ndonjë serbi nga shqiptarët.

Pos kësaj, serbët nga Obiliqi nuk kanë probleme me autoritetet komunale dhe juridike, edhe pse të punësuarit shqiptarë nganjëherë refuzojnë të komunikojnë në serbisht, edhe përkundrajt faktit që dinë ta flasin. Shumica e personelit janë shqiptarë, por është edhe një numër i konsiderueshëm i serbëve, dhe meqë formularët janë të shtypur në tri gjuhë, kjo është një situatë që mund të tejkalohet lehtë. Sipas njërit nga të intervistuarit, kjo nganjëherë krijon situata qesharake, në të cilat njerëzit gjatë komunikimit flasin dy gjuhë të ndryshme, por, megjithatë, ia dalin që ‘të kryejnë punë.’

Qeveria e Serbisë e ka një ndikim të madh në qytetarët serbë. Kjo ende ngulmon në ruajtjen e institucioneve paralele në Kosovë, të tilla si shkollat, fakultetet, klinikat dhe kuvendet komunale. Qeveria e Serbisë po ashtu ngulmon që serbët të mos marrin pjesë në jetën politike të Kosovës. Ndikimi negativ i Qeverisë Serbe është intensifikuar pas Shpalljes së Pavarësisë, me kërkesën që serbët t’i braktisin vendet e tyre të punës në institucionet e kontrolluara nga Qeveria e Kosovës. Nga ana tjetër, veprimet e pamjaftueshme të Qeverisë së Kosovës, njësoj si dhe incidentet sporadike, si për shembull mjeti shpërthyes i hedhur në banesën e Robert Savićit, serb ky nga Obiliqi, në dhjetor 2007, kanë, po ashtu, ndikim në frikën e vazhdueshme në mesin e komunitetit serb.

Përgjithësisht, të gjitha komunitetet pakicë kanë qasje të lirë në institucionet e Obiliqit, dhe kjo nuk ka ndryshuar as pas 17 shkurtit, 2008. Sidoqoftë, serbët, deri në një masë të caktuar, shërbimet që i ofron Zyra për Komunitete janë duke i shfrytëzuar gjithnjë e më pak.

## **ROMËT, ASHKALINJTË DHE EGJIPTASIT**

Pothuaj nëntë vite pas Luftës së Kosovës së vitit 1999, gjenjda e pakicave më të vogla të Kosovës – dhe në veçanti ajo e romëve, ashkalinjëve dhe e egjiptasve të Kosovës – vështirë që ka patur ndonjë përmirësim. Këta njerëz vazhdojnë t’i paraqesin grupet e popullatave më të varfëra në vend, dhe këta e kanë një qasje të kufizuar në tregun e punës, si dhe në shërbimet dhe edukimin publik. Vetëm pak nga ta mundën t’i marrin sërish vendet e tyre të mëparshme të punës. Ka patur fare pak që institucionet komunale kanë mundur të bëjnë lidhur me to, kur të mirren parasysht të gjitha kërkesat e të gjitha grupeve të tjera etnike me të cilat këto institucione kanë qenë të përballura.

## **MEDIUMET**

Obiliqi nuk e ka ndonjë stacion lokal televiziv, dhe ky, po ashtu, nuk ka as ndonjë gazetë lokale. E tërë komuna e Obiliqit i ka tri radio-stacione lokale: Radio Evropën, Radio M, dhe Radio Most (Radio Ura). Vetëm Radio Evropa emeton programe në të trija gjuhët,

ndërsa Radio M dhe Radio Most emetojnë programe vetëm në serbisht. Programet e lajmeve të Radio Evropës janë të bëra me një theks në ngjarjet lokale, ndërkohë që Radio M dhe Radio Most këto në masën më të madhe i marrin, ose nga Beogradi, ose nga emetuesit serbë rajonal.

Radio Evropa e paraqet një rast tejet interesant dhe të rëndësishëm, meqë, siç e thamë, emeton në të trija gjuhët (në periudha kohore të veçuara), dhe, po ashtu, programet i ka të përqendruara në përmbajtjet lokale.

Sa i përket shkallës së kënaqësisë me nivelin e informimit në dispozicion, ashkalinjtë dhe egjiptasit e këtij rajoni janë të kënaqur me sasinë e informatave që i marrin, dhe ata i dëgjojnë dhe i shikojnë të gjitha radio dhe TV programet në gjuhën shqipe, posaçërisht RTK-në (Radio Televizionin e Kosovës) dhe KTV-në (Koha Televizionin). Romët shprehin pakënaqësi, meqë nuk ka programe të mjaftueshme në gjuhën e tyre. Ata frikësohen me të drejtë që fëmijët e tyre mund ta harrojnë gjuhën e tyre amtare, dhe shprehin dëshirë ta kenë një gazetë në gjuhën rome, e cila do të raportonte në baza ditore rreth çështjeve dhe kulturës rome. Ata nuk pajtohen me atë që emetimet ditore pesëminutëshe të lajmeve, dhe programet javore 40-minutëshe në gjuhën rome në RTK, janë të mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat e tyre.

Nga ana tjetër, serbët ndjehen të kënaqur me nivelin e informatave në dispozicion për ta lidhur me ngjarjet e përgjithshme. Edhe qytetarët serbë, edhe ata romë, të Plemetinit, ankohen për mungesën e informatave rreth punës dhe aktiviteteve të komunës apo rreth vendeve të lira të punës. Ata e fajësojnë Zyren për Komunitete për këtë mungesë informatash. Në fshat nuk ka tabelë informimi për këto. Ata mësojnë rreth takimeve të komunës nga njerëzit që e kanë vizituar komunën.

Një numër fare i vogël i pjesëtarëve të pakicave e shfrytëzojnë Internetin për qasje në informata. Komunitetet pakicë e shprehin pakënaqësinë e tyre lidhur me informatat që jipen në tabelat e shpalljeve të komunave, të qyteteve dhe të fshatrave, edhe pse ne e kemi parë që informatat në tabelat komunale të shpalljeve ripërtëriheshin në të dyja gjuhët.

## **PËRDORIMI I GJUHËVE NË KOMUNË DHE NË NDËRMARRJET NË PRONËSI PUBLIKE**

Në Kushtetutën e Kosovës, Neni 5 mbi Gjuhët është pjesë e kapitullit Dispozitat Themelore. Në bazë të këtij Neni, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë shqipja dhe serbishtja, ndërsa, gjuhë turqishte, boshnjakishte dhe rome e kanë statusin e

gjuhëve zyrtare në nivelin komunal, ose do të jenë në përdorim zyrtar në të gjitha nivelet ashtu siç do të përcaktohet me ligj.<sup>24</sup>

Nga ana tjetër, Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve<sup>25</sup> e përcakton që në nivelin komunal, nëse një komunitet e flet një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare, dhe e paraqet të paktën 5% të popullatës së komunës, asaj gjuhe do t'i jipet statusi i gjuhës zyrtare në nivelin komunal. Po ashtu, nëse një komunitet e flet një gjuhë e cila nuk është gjuhë zyrtare, dhe e përbën midis 3% dhe 5% të popullatës së komunës, kjo gjuhë mund të bëhet një gjuhë “në përdorim zyrtar” në nivelin komunal.

Mirëpo, në jetën e mirëfilltë, paaftësia e pakicave për të folur shqip është një pengesë tjetër e cila e ka një ndikim të konsiderueshëm negativ në aspiratat e pjesëtarëve të tyre, dhe e pengon integrimin e tyre në shoqërinë e Kosovës.

Duke folur për rrethanat e përgjithshme të Kosovës, sa i përket gjuhës shqipe, turqit janë në gjendjen më të mirë, meqë shumica e tyre flet shqip. Shqipja është po ashtu gjuhë amtare e qytetarëve ashkalinjë dhe egjiptas të Kosovës. Megjithatë, boshnjakët e Kosovës, goranët, serbët dhe romët, që e flasin shqipen janë të paktë.

Deri më 17 shkurt 2008, ka qenë një përparim i dukshëm në përmirësimin e marrëdhënieve midis të gjitha komuniteteve etnike në Komunën e Obiliqit. Institucionet e Kosovës, si qendrore, ashtu edhe lokale, e kanë përkrahur publikisht integrimin e komunitetit serb në shoqërinë e Kosovës. Si pasojë, duke u mbështetur në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, në maj të vitit 2007 është themeluar Komisioni për Gjuhët.

Përpjekjet për përmirësimin e gjendjes së serbëve vazhduan edhe pas Shpalljes së Pavarësisë. Një e dhënë që e dëshmon këtë është se që nga 17 shkurti 2008, në Obiliq nuk është regjistruar as edhe një incident i vetëm që ka patur motivime etnike. Serbët ende mund t'i plotësojnë nevojat e tyre administrative në institucionet komunale. Megjithatë, duhet vërejtur ajo që pas 17 shkurtit serbët përgjithësisht ndjehen të pasigurtë, duke i përfshirë këtu madje edhe ata të rrallët që në fillim i lëshuan vendet e tyre të punës në institucionet e Kosovës, por që më vonë u kthyen në to.

Përdorimi i gjuhëve në komuna është i rregulluar, siç u përmend, me Nenet 7-9 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Obiliqi është një komunë në të cilën Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve zbatohet pothuaj në tërësi. I tërë dokumentacioni publik dhe i brendshëm, i tillë si vendimet e kolegjiut të drejtorëve, rezolutat dhe konkluzionet, udhëzimet administrative, udhëzimet mbi rregullat dhe rregulloret, janë përgatitur dhe botuar, edhe në shqip, edhe në serbisht. Mirëpo, uebsajti i komunës është funksional vetëm në shqip,

---

<sup>24</sup> Shih Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 5 (Gjuhët), në:

<http://www.kosovoconstitution.info/?cid=2,247>.

<sup>25</sup> Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve; No. 02/L-37.

gjë kjo e cila mund ta pengojë komunitetin serb për të patur një qasje më të lehtë në informatat publike dhe në përfshirjen e tyre në krijimin e politikave komunale.

Shenjat e vendosura në hyrjen e ndërtesës së komunës, emrat e shërbimeve komunale dhe të të punësuarve, informatat, shpalljet e klasifikuara brenda ndërtesës komunale, që të gjithat janë të shkruara në shqip dhe në serbisht. Të gjitha dokumentet lëshohen në gjuhën në të cilën klientët i bëjnë kërkesat. Megjithatë, qytetarët, që janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, nganjëherë ankohen meqë këto dokumente nuk janë të shkruara në pajtim me rregullat gjuhësore të gjuhës së tyre. Kjo ka kryesisht të bëjë me mënyrën në të cilën shqiptohen emrat serbë. Për shembull, në vend të emrit Snežana, i cili do të jetë i përpiktë sipas rregullave të ortografisë serbisht, zyrtarët shkruajnë Snezhana, e cila është në pajtim me ortografinë shqipe. Për të punësuarit e administratës komunale nuk është organizuar asnjë kurs i gjuhëve shqipe apo serbe.

Emrat e rrugëve dhe të lagjeve janë të shkruar në shqip dhe në serbisht (edhe pse, në disa raste, shkrimi në serbisht nuk shihet meqë ishte i stërpikur me ngjyrë spreji). Vula komunale është në shqip, anglisht dhe në serbisht, ndërkaq, llogoja është në gjuhën shqipe. Uebfaqja komunal është ndërtuar dhe është funksional në shqip, por jo edhe në serbisht dhe në anglisht.

Duhet patur parasysh atë se nga aspekti i gjykatës komunale komuna e Obiliqit mbetet nën jurisdiksionin e Gjykatës Komunale të Prishtinës; ndërkaq, Gjykata Komunale e Prishtinës, më tutje, duket se Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve e respekton në tërësi.

Gjuhët Zyrtare në Gjykatat Komunale dhe Rajonale të Prishtinës janë shqipja dhe serbishtja. Të gjithë zyrtarët komunikojnë me klientët në gjuhën në të cilën klientët iu janë drejtuar. Nëse ata nuk e njohin atë gjuhë, atëherë e kërkojnë përkthyesin. Përkthimi simultan ofrohet në procese gjyqësore, dhe të gjitha palët e përfshira në procedurë e ndjekin rrjedhën dëgjimore në gjuhën e tyre amtare. Fletëthirrjet për gjyq janë në formularë të shkruar, edhe në shqip, edhe në serbisht. Të gjithë gjykatësit i marrin dokumentet e nevojshme në gjuhën e tyre amtare. Të gjitha ligjet në Gazetën Zyrtare janë të botuara në anglisht, shqip dhe serbisht. Gjykatat Komunale dhe Rajonale të Prishtinës, si dhe gjykatat e tjera të tilla në Kosovë, nuk i kanë botimet e veta. Gjykatësit në Kosovë i marrin informatat rreth veprimtarive të ndryshme përmes Gjykatës Supreme apo Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës. Informatat e tjera dhe Buletini janë në shqip, anglisht dhe serbisht.

Vendimet e gjykatave përgatiten në pajtim me kombësinë e palës. Gjykatësit boshnjakë, për shembull, planin e veprimtarisë së tyre e përgatitin në boshnjakisht. Ata i shkruajnë në gjuhën e tyre edhe vendimet e gjykatës. Ky dokument, më pastaj, nëse palët pjesëmarrëse janë shqiptare, përkthehet në shqip. Gjykatësit shqiptarë e bëjnë të njëjtën – ata vendimet e tyre të gjykatës i shkruajnë në shqip, dhe këto më pastaj përkthehen në gjuhën e palëve.

Nga ana tjetër, një varg i intervistave janë bërë me zyrtarët për marrëdhënie me publikun në kompanitë publike që veprojnë në Obiliq. Qëllim i këtyre intervistave ishte të vlerësohet përmasa deri në të cilën kompanitë publike i punësojnë pjesëtarët e komuniteteve pakicë, dhe për ta konstatuar numrin e të punësuarve nga pakicat, mundësitë e tyre për ta përdorur gjuhën amtare në vendin e punës, njësoj si dhe për ta konstatuar marrëdhënien midis kompanive publike dhe shfrytëzuesve përfundimtarë të shërbimeve të tyre (d.m.th., në çfarë gjuhe janë faturat, kontratat dhe informatat e tjera që lëshohen).

Thënë në përgjithësi, kjo situatë do të mund të përkufizohej si “e zymtë.” Edhe pse kompanitë publike të shumtën i respektojnë rregullat që kanë të bëjnë me gjuhën, praktikat e tyre të punësimit lëjnë mjaft shumë për të dëshiruar. Nga pjesëtarët e pakicave që jetojnë në Obiliq, KEK-u shihet si një kompani publike e cila i favorizon shqiptarët.

Kontratat e punësimit për të gjithë të punësuarit përgatiten në ndërtesën qendrore të KEK-ut në Prishtinë. Kontratat e punësimit dhe i tërë dokumentacioni tjetër, përfshirë këtu edhe autorizimet e kërkesave për pushim, të punësuarve serbë u lëshohen në gjuhën serbe. Disa të punësuar serbë që kanë filluar të punojnë për kompaninë para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve, kontratat e tyre të punës i kanë pranuar në gjuhën shqipe. Kontratat përkthehen në gjuhën serbe në pajtim me ligjin. Dokumentacioni i brendshëm i KEK-ut, krahas me informatat në tabelat e shpalljeve, emrat e të punësuarve dhe emrat e departamenteve të ndryshme, janë që të gjithat në shqip. Në KEK ekziston zyra e përkthimit. Kjo zyre është përgjegjëse për përkthimin e dokumenteve në gjuhët serbe dhe anglishte, dhe për përkthimet nga gjuhët tjera në shqip. Faturat e energjisë lëshohen në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Komunikimi me konsumatorët bëhet në gjuhën në të cilën këta u drejtohen të punësuarve të KEK-ut.

Konkurset për vendet e punës KEK-u i shpall në gazetatat ditore në gjuhët shqipe dhe serbishte. Uebajti i KEK-ut është në shqip, anglisht dhe serbisht. Ky ripërtërihet në të trija gjuhët. Komunikimi midis kolegëve zhvillohet lirshëm në të gjitha gjuhët. Të punësuarit e KEK-ut konsumatorëve u ofrojnë shërbim duke u përgjegjur në gjuhën në të cilën ata u janë drejtuar.

Nuk ka ndonjë informatë të sigurtë rreth numrit të pjesëtarëve të pakicave që para Luftës kanë punuar për Industrinë e Energjisë Elektrike të Serbisë (EPS), pasardhës i të cilës është KEK-u. Në të vërtetë, nuk ka informata të sigurta rreth përqindjes së të punësuarve, pjesëtarë të pakicave, që kanë punuar para luftës fare. Shumica e punëtorëve nuk janë paraqitur në punë pas luftës, me mjaft gjasë për shkak të rrethanave që ishin krijuar, por, në të njëjtën kohë, kishte edhe arsye politike se pse serbët refuzuan të kthehen në punë. Sipas përgjegjësit për marrëdhënie me publikun në KEK, EPS-ja ende u jep paga rreth 7.000 deri në 8.000 ish të punësuarve, gjë kjo e cila asaj i mundëson të ushtrojë trysni në ta për ta refuzuar pjesëmarrjen në “kompanitë e Kosovës.” Një rrëfim i

ngjashëm mund të haset edhe në rastin e “Kompanive Rajonale Publike të Ujësjetësimit dhe Kanalizimit” në Prishtinë, e cila është përgjegjëse për dhënien e shërbimeve të veta edhe në Obiliq. Kompanitë Publike Sanitare të Qytetit që janë përgjegjëse për mirëmbajtjen e pastërtisë së qytetit, përfshirë këtu edhe parqet dhe varrezat, punëtorëve të vet u japin kontrata të punës në gjuhët e tyre amtare. Por, përsëri, i tërë dokumentacioni, informatat në zyrat qendrore të kompanive sanitare, emrat e të punësuarve dhe të departamenteve, janë të shkruara vetëm në shqip.



## REKOMANDIMET:

- Kuvendi Komunal i Obiliqit duhet ta ripunojë Statutin e vet në pajtim me legjislacionin kombëtar sa i përket procedurave të parapara për emërimin dhe shkarkimin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete.
- Kuvendi Komunal duhet ta zgjedhë Zëvendës Kryesuesin për Komunitete dhe t'i përmbush kësaj obligimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni kombëtar dhe komunal.
- Komuna duhet ta themelojë njësinë për përkthime dhe ta forcojë atë me personel profesional, ashtu që ta zbatojë në një mënyrë zyrtare Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
- Në bashkëpunim me Qeverinë kombëtare, Komuna e Obiliqit duhet të bëjë përpjekje shtesë për ta përmirësuar gjendjen e komuniteteve etnike sa i përket të drejtave të pakicave të Kosovës për punësim në ndërmarrjet në pronësi publike, dhe për të siguruar që pjesëtarët e komuniteteve që punojnë në kuadër të kompanive publike në rajonet e veçanta, ta pasqyrojnë përbërjen etnike të rajonit ku kompania publike në fjalë vepron.
- Institucionet e Qeverisë Qendrore duhet të merren me mungesën e koherencës midis dispozitave kushtetutare që e garantojnë punësimin përpjestimor të pjesëtarëve të pakicave në kompanitë në pronësi publike, dhe pavarësisë përmbajtësore të këtyre kompanive e cila atyre u krijon hapësirë për ta shmangur këtë obligim kushtetues.
- Sa i përket tri rekomandimeve të mëparshme, një theks i veçantë duhet t'i jipet gjendjes së komuniteteve të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve.
- Komuna duhet ta negociojë një marrëveshje me kompanitë publike të transportit në qytetin e Obiliqit, ashtu që të krijojnë lidhje të rregullta me autobusë për të gjitha pjesët e Obiliqit.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës (MASHT), duhet ta zhvillojë planprogramin dhe t'i ofrojë të gjitha tekstet shkollore për edukim në gjuhën serbe, si për nxënësit serbë, ashtu edhe për ata që u takojnë pakicave të tjera që dojnë të edukohen në gjuhën serbe.
- Komuna e Obiliqit duhet t'i shfrytëzojë sa më mirë që të jetë e mundur Komitetin për Komunitete dhe Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete me qëllim të përmirimit të gjendjes dhe të kushteve të komuniteteve pakicë në komunë.
- Përpjekjet që kanë për qëllim përparimin e mëtutjeshëm në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhës duhet të vazhdojnë. Komuna duhet ta nisë urgjentisht një fushatë që ka për qëllim informimin e qytetarëve të Obiliqit dhe të personave të punësuar në institucionet publike rreth përgjegjësive të institucioneve sa i përket Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Gjatë procesit të informimit të qytetarëve, Komuna duhet t'i synojë komunitetet pakicë, ashtu që atyre t'ua bëjë të njohura

të gjitha instrumentet që i kanë në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre minoritare.

- Qeveria e Kosovës dhe autoritetet komunale të Obiliqit duhet ta inkurajojnë dhe ta nxisin pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në zgjedhjet e ardhshme komunale, me qëllim që ta rrisin legjitimitetin e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur.

**POLITIKAT LOKALE NË KOMUNITETET  
MULTIETNIKE**

***RASTI STUDIMOR: GJILANI***

## HYRJE: NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I KOMUNËS

Komuna e Gjilanit është njëra nga 7 komunat më të mëdha në Kosovë. Kjo ndodhet në një distancë prej rreth 47 kilometrash në juglindje të Prishtinës, dhe e ka një sipërfaqe prej 515 km<sup>2</sup>. Kjo komunë është, po ashtu, edhe qendër administrative e Zonës së Gjilanit.<sup>26</sup> Gjilani është në kufi, edhe me Maqedoninë, edhe me Serbinë. Pos qytetit, komuna i ka 63 fshatra dhe është e ndarë në 54 zona kadastrale.

Sipas të dhënave të Zyrës Statistike të Kosovës të dhjetorit 2002, popullata e tërësishme vlerësohet të jetë 133.724 banorë (68.814 meshkuj, dhe 64.910 femra), nga të cilët 116.246 banorë janë shqiptarë të Kosovës dhe 17.478 banorë u takojnë komuniteteve të tjera. Numri i tërësishëm i banorëve që jetojnë në zonat urbane është 79.898, ndërkaq, të tjerët janë të shpërndarë nëpër zonat rurale. Komuna e ka një mesatare prej 259 banorësh për kilometër katror. Këto shifra janë vlerësime komunale, meqë regjistrim nuk ka patur që nga viti 1981. Sa i përket popullatës para vitit 1981, tabela e mëposhtme i ilustron ndryshimet në popullatë gjatë dekadave pas Luftës së Dytë Botërore. Shkalla mesatare e natalitetit është rreth 3.360 të lindur në vit, ndërkaq, numri i vdekjeve është rreth 384 në vit.

Viti/Popullata	Shqiptarë	%	Serbë	%	Romë	%	Të tjerë	%	Totali
1953	24,797	50.87	19,196	39.32					48,748
1961	29,942	57.12	18,297	34.91	735	1.50			52,415
1971	43,754	64.45	20,237	29.81	1,824	2.69			67,893
1981	59,764	71.08	19,212	22.85	3,347	3.98	1,762	2.1	84,085
2002*	116,246	86.9	12,500	9.4	3,610	2.7	1368	1.02	133,724

Burimi: Për të dhënat deri në vitin 1981, Regjistrimet jugosllave të popullatës; të dhënat për vitin 2002 vijnë nga Zyra Statistike e Kosovës.

Shtatë fshatra të Gjilanit janë të banuara ekskluzivisht nga serbë të Kosovës. Turqit e Kosovës jetojnë në qytetin e Gjilanit, si dhe në tri fshatra. Në Komunën e Gjilanit, ndaras nga zona urbane, janë pesë fshatra etnikisht të përziera.

<sup>26</sup> Kjo zonë i përmban komunat e Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë. Në vitin 2000, UNMIKu e bëri një ndryshim të zonave të pas-1990-ës, duke ia ndërruar emrin Zonës Kosovo-Pomoravlje në Zonën e Gjilanit (ashtu siç ishte para vitit 1989), dhe e barti komunën e Novobërdës në Zonën e Prishtinës.

Në vitin 1999, ngjitur me qytetin, në vendin e një baze të shkatërruar ushtarake serbe, u themelua Kampi Monteith, si një bazë për operacionet e KFOR-it. Ndërkaq, në vitin 2007, kur Ushtria e Shteteve të Bashkuara e uli efektivin e trupave të veta në Kosovë, ky Kamp iu dorëzua Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Gjilani ka shërbyer, po ashtu, edhe si seli rajonale e forcave të posaçme të Policisë Ndërkombëtare të UNMIK-ut që nga viti 1999, dhe ky është po ashtu edhe seli rajonale e EULEX-it që nga mesi i prillit 2009.

## **LEGJISLACIONI KOMUNAL**

Kuvendi Komunal e Gjilanit e ka përvetësuar një numër aktesh ligjore që i kanë dhënë dispozitat ligjore për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve. Në mes tjerash, këto akte ligjore e përfshijnë Statutin e Komunës, Vendimin Komunal Nr. 01.1026, për Aprovimin e Rregullores për Përdorimin Zyrtar të Gjuhëve në Komunën e Gjilanit, Rregulloren për Përdorimin Zyrtar të Gjuhës në Gjilan, dhe Vendimin Komunal Nr. 01.3991/0101, domethënë, Shpalljen e Gjuhës Turke si Gjuhë në Përdorim Zyrtar në Komunën e Gjilanit.

### **Statuti i Komunës së Gjilanit**

Statuti i Komunës së Gjilanit ka dispozita të shumta rreth mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të komuniteteve pakicë.

Së pari, Neni 6.2 e parasheh që Vulat e Komunës së Gjilanit duhet të jenë të shkruara në gjuhët shqipe, serbishte dhe turqishte. Neni 9.2 e konfirmon përkushtimin e Komunës së Gjilanit ndaj të drejtave dhe lirive njerëzore të qytetarëve të vet, pavarësisht etnisë, gjuhës, fesë, gjinisë, racës, dhe pikëpamjeve politike të tyre. Kjo vazhdon me proklamimin e barazisë së qytetarëve të Gjilanit gjatë marrjes së shërbimeve komunale në të gjitha nivelet.

Pjesa “Gjuhët” (Neni 47) e parasheh të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë për të komunikuar në gjuhën e tyre me të gjitha organet dhe me të gjithë shërbyesit civilë të Komunës. Ky, po ashtu, specifikon që takimet e Kuvendit Komunal, të komiteteve komunale, të trupave komunal ekzekutiv, dhe të gjitha takimet publike duhet të mbahen në dy gjuhë: shqip dhe serbisht. Po të kërkohet, aktet dhe procesverbalet do të përkthehen në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë. Takimet mund të mbahen, po ashtu, edhe vetëm në shqip, nëse pjesëmarrësit arrijnë pajtim për këtë.

Neni 62.1 i Statutit e përcakton themelimin e Komitetit për Komunitete si njëri nga komitetet e përhershme të Kuvendit Komunal. Ky Komitet përkufizohet më tutje në Nenin 67. Anëtarët e Komitetit të Komuniteteve i zgjedh Kuvendi Komunal, nga mesi i anëtarëve të Kuvendit Komunal, si dhe i përfaqësuesve të komuniteteve pakicë. Ky Komitet i ka 7 anëtarë.

Më tutje, Neni 71.1 dhe 2, e përcaktojnë që çdo komunitet që jeton në komunë duhet të përfaqësohet nga të paktën një përfaqësues në Komitetin për Komunitete, dhe që përfaqësuesit e komuniteteve pakicë duhet ta përbëjnë shumicën e këtij Komiteti. Ky Komitet është përgjegjës për analizimin e pajtueshmërisë të të gjitha autoriteteve komunale me ligjet në fuqi, njësoj si dhe për analizimin e të gjitha politikave, praktikave dhe aktiviteteve komunale, ashtu që të sigurohet që të gjitha interesat e komunitetit të respektohen në tërësi. Kjo bëhet përmes rekomandimeve për Kuvendin Komunal rreth masave që duhen ndërmarrë për ta siguruar zbatimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojat e komuniteteve për t'i shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetet e veta etnike, kulturore dhe linguistike.

Neni 72 e përkufizon pozitën e Zëvendës Kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete. Ky post mbahet nga kandidati që e përfaqëson popullatën jo-shumicë i cili e fiton shumicën e votave në zgjedhjet për Kuvendin Komunal. Zëvendës Kryesuesi për Komunitete i ushtron detyrat e veta në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Pozita e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete përkufizohet në Nenin 84. Zëvendës Kryetari për Komunitete i Komunës së Gjilanit emërohet për të njëjtin mandat si dhe Kryetari i Komunës. Me propozimin e Kryetarit të Komunës, emërimi dhe shkarkimi i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal të pranishëm që votojnë, njësoj si dhe nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal që i takojnë komuniteteve, të pranishëm dhe që votojnë. Kur posti i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete të mbetet e lirë, Kryetari i Komunës e propozon Zëvendës Kryetarin e ri, jo më vonë se 30 ditë që nga momenti kur posti ka mbetur i lirë. Zëvendës Kryetari për Komunitete i jep këshilla dhe udhëzime Kryetarit rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë.

### **Rregullorja mbi Shfrytëzimin Zyrtar të Gjuhëve**

Kjo Rregullore e përcakton që gjuhë zyrtare në Komunën e Gjilanit janë shqipja dhe serbishtja, dhe që të gjitha komunitetet kanë të drejta të barabarta lidhur me përdorimin e gjuhëve të tyre në të gjitha institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e tjera komunale që ofrojnë shërbime komunale publike. Lidhur me përdorimin e gjuhëve, duhet të theksohet

se me Vendimin Komunal 01.3991/0101, gjuha turke është shpallur si gjuhë në përdorimi zyrtar në Komunën e Gjilanit.

Nuk janë vërejtur shpërputhje apo kundërthënie midis legjislacionit komunal të Komunës së Gjilanit dhe kornizës ligjore në nivelin kombëtar.

## **PJESËMARRJA POLITIKE**

Më parë, Komuna e Gjilanit është udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), por rezultatet e nëntorit 2007 sollën ndryshime në pamjen politike të kësaj komune. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i fitoi kuvendin komunal dhe zgjedhjet për kryetar të komunës.

Kryetar i Komunës së Gjilanit është zgjedhur z. Qemajl Mustafa, ndërkaq, në zgjedhjet për Kuvendin Komunal, PDK fitoi 34,26% të votave, LDK 20,32%, LDD 15,03%, AKR 14,25%, AAK 9,21%, ORA 2,70% dhe PD 1,89%. Në komunën e Gjilanit, serbët e Kosovës e përkrahën thirrjen për bojkotimin e zgjedhjeve nga ana e Qeverisë së Serbisë, dhe votuan vetëm me një numër të vogël. Qeveria e re komunale e themeloi një koalicion midis PDK-së, AKR-së dhe AAK-së.

Edhe përkundrejt faktit që Kryetari Mustafa i fitoi zgjedhjet për kryetar me një margjinë përmbajtësore, si pasojë e shpërndarjes së votave për Kuvend midis disa partive politike, problemi i tij kryesor menjëherë pas zgjedhjeve ishte ta stabilizonte koalicionin udhëheqës që u krijua në Kuvend. Kësisoj, gjatë disa muajve të ardhshëm u emëruan vetëm katër Drejtorë të Departamenteve Komunale: Edukimi dhe Kultura (PDK); Përkujdesi Shëndetësor dhe Mirëqenia Sociale (AAK); Financat, Ekonomia dhe Zhvillimi (PDK); dhe Planifikimi Urban, Kadastru dhe Mbrojtja e Mjedisit (AKR). Në muajt vijues, u emëruan të gjithë drejtorët e të gjitha departamenteve të tjera. Administrata komunale përbëhet nga njëmbëdhjetë Drejtorë dhe nga Zyra Lokale e Komuniteteve.<sup>27</sup>

---

<sup>27</sup> Administrimi dhe Personeli; Financat, Ekonomia dhe Zhvillimi; Përkujdesi Shëndetësor dhe Mirëqenia Sociale; Edukimi, Rinia, Kultura dhe Sporti; Planifikimi Urban dhe Mjedisit; Kadastru, Gjeodezia, Prona dhe Banimi; Inspektorati; Pylltaria dhe Bujqësia; Emergjencat dhe Ndihma Sociale; Shërbimet Publike.

## INSTITUCIONET KOMUNALE MBI KOMUNITETET

Për shkak të pjesëmarrjes simbolike të komunitetit serb në zgjedhjet komunale të nëntorit 2007, komuniteti më i madh pakicë në Gjilan nuk e ka ndonjë përfaqësim të zgjedhur drejtpërdrejtë në Kuvendin Komunal. Sidoqoftë, Ligji për Vetëqeverisjen Komunale (Neni 54.2) e parasheh që nëse komunitetet jo-shumicë, për çfarëdo arsyeje, nuk e kanë ndonjë këshilltar në Kuvendin Komunal, atëherë Kuvendi Komunal duhet ta zgjedhë si Zëvendës Kryesues kandidatin e komunitetit jo-shumicë i cili e ka fituar numrin më të madh të votave në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet për Kuvendin Komunal. Kuvendi Komunal i Gjilanit e ka përmbushur këtë obligim ligjor duke e zgjedhur z. Srđan Jovanovićin si Zëvendës Kryetar të Kuvendit Komunal për Komunitete.

Kuvendi Komunal i Gjilanit e ka themeluar edhe Komitetin për Komunitete. Ky Komitet i ka shtatë anëtarë, dhe katër nga ta vijnë nga komunitetet pakicë. Kryesues i Komitetit është zgjedhur z. Kemal Sahin i komunitetit turk. Ky Komitet është tejet aktiv, dhe në gjysmën e parë të vitit, i ka mbajtur gjashtë mbledhje.<sup>28</sup>

Megjithatë, komunitetet pakicë kanë mbetur të papërfaqësuara në nivelin e ekzekutivit komunal. Autoritetet në Gjilan nuk e kanë zgjedhur ende Zëvendës Kryetarin e Komunës për Komunitete, duke mos e përmbushur kështu obligimin ligjor që buron, si nga legjislacioni kombëtar, ashtu edhe nga ai komunal. Po ashtu, në Komunën e Gjilanit, komunitetet nuk janë të përfaqësuar në pozitat udhëheqëse në nivelin e drejtorive komunale.

Komuna e ka njësinë përkthyesë e cila i përmbush nevojat për përkthime.<sup>29</sup> Kjo po ashtu e ofron shërbimin e transportit për të gjitha komunitetet. Po ashtu, në gjysmën e parë të vitit 2009, nuk është regjistruar as edhe një rast i vetëm i shkeljes së të drejtave të komuniteteve pakicë.<sup>30</sup>

Numri i tërësishëm i të punësuarve në Komunën e Gjilanit është 289, ku 3 janë të emëruar politikë, dhe 286 janë shërbyes civilë. Në nivelin politik, 2 të emëruar janë shqiptarë, dhe 1 është serb. Në nivelin e shërbimit civil, nga gjithsej 286 të punësuar, 246 (86,01%) janë shqiptarë, ndërkaq 40 (13,99%) janë nga komunitetet jo-shumicë: 37 serbë (12,84%), dhe 3 turq (1,05%). Sa i përket nivelit të punësimit në nivelin drejtues, nga numri i tërësishëm i 37 të të punësuarve në këtë nivel, 33 (89,1%) janë shqiptarë, dhe 4 (10,81%) janë serbë. Struktura në nivelin administrativ është si vijon: nga gjithsej 249 të punësuar, 213 (85,54%) janë shqiptarë, dhe 36 (14,46%) janë pjesëtarë të komuniteteve jo-shumicë: 33 serbë (13,25%), dhe 3 turq (1,21%).

<sup>28</sup> Raporti i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar – Qershor 2009, . Ministria e Admsitrimt të Pushtetit Lokal, Korrik 2009, fq. 32.

<sup>29</sup> Ibid., fq. 33.

<sup>30</sup> Ibid., fq. 32.



## RRETH DECENTRALIZIMIT NË GJILAN

Komuna e Gjilanit është një nga komunat e Kosovës e cila do të preket më së shumti në territorin, në qytetarët, dhe në organizimin e vet të ardhshëm, nga procesi i decentralizimit dhe i krijimit të komunave të reja me shumicë nga komuniteti serb. Së pari, në kuadrin e territorit të tashëm të Komunës së Gjilanit, parashihet krijimi i Komunës së Parteshit. Së dyti, do të vijë deri te rritja e territorit të komunës fqinje të Artanës, dhe kjo po ashtu parashihet të ndodhë në hesap të territorit të Gjilanit. Këto ndryshime territoriale mund ta kthejnë komunën e Gjilanit në një komunë me rreth 10% më pak popullatë, gjë kjo e cila në të ardhmen mund ta ndryshojë kornizën e saj legale për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të komuniteteve.

Qyteti i Gjilanit ka qenë në gjendje ankthi rreth decentralizimit përgjatë vijave etnike, duke argumentuar që një pjesë shumë e madhe e komunës do të shkëputet, gjë kjo e cila do ta bëjë komunën të paqëndrueshme. Udhëheqësia lokale e partive politike shqiptare në rajonin e Gjilanit beson që decentralizimi do t'i bëjë komunat jofunksionale, si të rejat, ashtu edhe ato që do të mbeten nga të vjetrat. Degët e të gjitha partive dhe organizatave politike relevante, e kanë kundërshtuar fuqishëm Ekipin Negociator të Kosovës (që rëndom është thirrur si "Ekipi i Unitetit"), dhe e kanë akuzuar për nxitjen e ndarjes së Kosovës. Këshilli i Protestave të komunës, duke qenë kundër propozimit të parashtruar nga Ekipi Negociues, e ka kërkuar dorëheqjen e këtij Ekipi.

Kreu i atëhershëm i PDKsë në Gjilan, tash Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa, e ka theksuar që "propozimi për decentralizim, Gjilanin do ta rrethojë me një mur, në gjithsej 400km<sup>2</sup>, ndërkohë që komuna me gjithsej 12.000 banorë, do të fitojë 230 km<sup>2</sup> të tokës. Decentralizimi do t'ia marrë Gjilanit një pjesë shumë të madhe të territorit të tij, do t'ia marrë atij tokën e tij të punueshme, resurset e tij ujore dhe qyteti do të lihet me asgjë; pos planeve të tilla të decentralizimit, rrugët kryesore të komunikimit do të mbyllen." Aktivistët kundër decentralizimit në këtë komunë argumentojnë që "nëse një decentralizim i këtij lloji është çmim për pavarësinë e Kosovës, atëherë kostoja është tepër e lartë." Kjo nismë kulmoi në mbi 30.000 nënshkrime, të grumbulluara nga qytetarët që fuqimisht kërkojnë që decentralizimi përgjatë vijave etnike të ndërpritet.

Një nga çështjet kryesore, sa i përket procesit të decentralizimit, është që fshatrat serbe në komunën e Gjilanit janë të palidhura dhe shumë larg njëri-tjetrit, nganjëherë edhe me nga 20 kilometra, krahasuar me fshatrat në Graçanicë dhe në komunën e Vitisë, të cilat janë mjaft kompakte. Prandaj, procesi i decentralizimit në rajonin e Gjilanit është duke u bërë në rrethana paksa më të ngatërruara. Domethënë, shumica e fshatrave serbe, tash nën jurisdikcionin e Gjilanit, do t'i bashkangjiten komunës së Artanës/Novobërdës, një numër i fshatrave të komunës së Kamenicës do t'i bashkangjiten po ashtu komunës së

Artanës, si dhe do të formohet komuna e re e Parteshit (fshat serb, që tash është nën jurisdikcionin e komunës së Gjilanit).

Komuna e Parteshit propozohet të përbëhet nga tri zona të vogla kadastrale me popullatë ekskluzivisht serbe, që do të transferohen nën kontrollin e saj nga komuna e Gjilanit. Kjo komunë do ta ketë 5,48% të territorit të zonës komunale të Gjilanit para procesit të decentralizimit. Sipërfaqja e plotë e komunës së re të Parteshit është 28,66 kilometra katrorë.

Kjo është një komunë e pastër jo-industriale me përqendrim në bujqësi, në saje të karakteristikave të veta territoriale. Është argumentuar nga Komuna e Gjilanit që infrastruktura në Komunën e propozuar të Parteshit është e pazhvilluar, në saje të antagonizmit midis zonave urbane dhe komunës amë. Parteshi do t'i ketë përafërsisht midis 4 dhe 5 mijë banorë, meqë një aproksimim i popullatave i bërë në qershor 2007 i dha 5.217 banorë në zonën e cila do të jetë komuna e Parteshit. Popullata në Komunën e Parteshit është e përbërë ekskluzivisht nga serbë të Kosovës, dhe nuk janë të raportuar pjesëtarë të grupeve të tjera minoritare. Fshatrat serbe që për momentin janë nën jurisdikcionin e komunës së Gjilanit, dhe që do t'i bashkangjiten komunës së Artanës janë: Kushcja e Epërme, Strazha, Stanishori, Koretishta, Makreshi i Epërm dhe i Poshtëm, Draganaci, Mozgova, Paralova dhe Melci (një vlerësim nga banorët është që në këto fshatra jetojnë përafërsisht 6.000 serbë).

Ajo që e përfaqëson një problem të madh është që rreth 6.000 serbë do të mbeten duke jetuar jashtë komunës së re të Parteshit dhe jashtë komunës së zgjeruar të Artanës. Në procesin e decentralizimit nuk janë të përfshira fshatrat vijuese të komunës së Gjilanit: Shillova, Poneshi, Livoqi i Epërm, Kmetoci dhe Cernica. Në të vërtetë, problemi më i madh është fshati Shillovë, që ndodhet vetëm disa kilometra nga qendra e qytetit të Gjilanit, dhe i cili konsiderohet qendra e të gjitha tubimeve politike dhe të tjera të komunitetit serb, dhe që është një nga fshatrat më të mëdha serbe në rajonin e Gjilanit. Banorët e Shillovës, që nga fillimi, kanë konsideruar që është më e mira që qendra e komunës së re të jetë në fshatin e tyre, dhe jo në Partesh, dhe ata e kanë refuzuar çdo lloj marrëveshjeje rreth çështjes së bashkangjities në komunën e Parteshit. Edhe pse fshati i Shillovës në fillim nuk ishte i përfshirë në procesin e decentralizimit, mundësia e zgjidhjes ka qenë e pranishme, por për shkak të grindjeve të brendshme kjo nuk është arritur. Arsyeja kryesore për këtë ishte kundërshtimi i Shillovës për t'iu bashkangjitur ndonjë komune qendra e të cilës nuk do të jetë në fshatin e tyre.

Sidoqoftë, procesi i decentralizimit në komunën e Gjilanit ka filluar, njoftimet për ekipet përgatitore janë botuar, dhe këto ekipe pritet të fillojnë punën e tyre në muajt në vijim. Është bërë fare pak sa i përket Organizimit Komunal, meqë komunat ende nuk janë të organizuara rreth kësaj. Komuna amë e mban një zyre të vogël dhe disa objekte arsimore dhe shendetësore.

## **ZHVILLIMI EKONOMIK DHE PUNËSIMI**

Ngjashëm me komunat e tjera të Kosovës, ekonomia e Gjilanit në masën më të madhe është e përqendruar dhe është zhvilluar rreth ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Kjo e paraqet një ndryshim të konsiderueshëm kur të krahasohet me periudhën heret në vitet 1980, kur industria ishte mjaft e zhvilluar, dhe e përqendruar në sektorë të veçantë, për të cilët njohuritë tradicionale, njësoj si dhe pozita gjeografike e komunës, ofronin një mjedis të mirë. Sektorët si tekstili, duhani, bateritë, radiatorët, etj., ishin shtylla kurrizore e zhvillimit ekonomik të komunës.

Situata në përkeqësim e sipër gjatë dekadës para Luftës së vitit 1999, e ka bërë riaktivizimin e këtyre potencialeve tejet të vështirë. Do të mund të thuhej që me privatizimin e fabrikës, industria e duhanit, deri në një masë, është kthyer, edhe përkundrajt faktit që sipas zyrtarëve komunalë, ka ende vështirësi të mbetura, që kanë të bëjnë me furnizimin me lëndë të para, të cilat më parë prodhoheshin kryesisht nga fshatarët e Gjilanit. Sektorët e tjerë janë duke e patur po ashtu një përmirësim të vogël, dhe për to raportohet që kanë qenë të suksesshme në furnizimin, jo vetëm të tregut kosovar, por edhe të atij rajonal, me të mirat e veta.

## **PËRKUJDESI SHËNDETËSOR**

Sa i përket përkujdesit shëndetësor, Gjilani i ka 33 Ambulanca, dhe 2 Qendra të Mjekësisë Familjare, njëra nga të cilat është kryesore. Njëkohësisht, në Gjilan ndodhet Spitali Rajonal i cili i përmbush nevojat e këtij rajoni.

Këto institucione janë të drejtuara nga kumuna, dhe në nivelet e ndryshme, këto i punësojnë 318 punëtorë. Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi në komunë ka aftësim profesional mjekësor, dhe është duke lobuar për përmirësimin, edhe të kushteve të punës, edhe të numrit të personelit të punësuar, i cili, ashtu siç ajo ngulmon, është i vogël dhe joadekuat për madhësinë e popullatës të cilën e mbulon. Buxheti komunal për shëndetësi për vitin 2009 është 1.304.686 €.

Të gjitha fshatrat serbe në komunën e Gjilanit kanë ambulanca elementare. Pos kësaj, në fshatin Shillovë është Departamenti i Mjekësisë Interne dhe i Pediatriisë, ndërkohë që Ambulanca Kirurgjike është në fshatin Koretishtë.

## **EDUKIMI**

Gjilani i ka 20 shkolla që veprojnë me planprogramet sipas ligjeve të Ministrisë së Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës, dhe 13 të tjera, që veprojnë përmes komunës paralele serbe. Nga 20 shkollat e para, 14 janë fillore, dhe 6 të tjerat janë shkolla të mesme.

Në komunë, janë 1.971 punëtorë të punësuar në këtë sektor. Sipas kornizës së re ligjore për edukim në veprim e sipër, komunat kanë më tepër kompetenca se më parë, dhe, rrjedhimisht, këto mund të përfshihen më tepër në këtë fushë. Janë disa çështje me të cilat përballet ky sektor, si në aspektet infrastrukturore, ashtu edhe në ato të resurseve njerëzore. Hapësira shkollore është e pamjaftueshme, dhe edhe përkundrejt faktit që ka patur përpjekje të shumta që janë bërë për zbutjen e kësaj situatë, shtrëngesat buxhetore kanë shkaktuar kufizime të shumta. Komuna planifikon të ndërtojë shtatë shkolla të reja, dhe, sipas Drejtorit të Drejtoratit të Edukimit, kjo do ta zbusë gjendjen. Megjithatë, duke i patur parasysh ndryshimet shumë të mëdha demografike, mbetet të shihet nëse kjo do t'i zgjidhë vështirësitë. Objektet ekzistuese kërkojnë investime të vazhdueshme, të cilat, komuna mjaft shpesh nuk është në gjendje t'i ofrojë. Buxheti komunal për edukim për vitin 2009 është 7.563.930 €.

Sa i përket edukimit, fshatrat serbe janë në një gjendje mjaft të mirë. Vetëm në Partesh janë katër shkolla fillore, dy shkolla të mesme dhe dy shkolla të larta, me një numër të tërësishëm prej më tepër se 1.150 nxënësish. Procesi edukativ në fshatrat serbe bëhet sipas planprogrameve të Republikës së Serbisë. Të gjitha fshatrat në komunën e Gjilanit kanë shkolla fillore. Shkollat e mesme janë në fshatrat Kushçë, Shillovë dhe Koretishtë.

## **KOMUNITETET JO-SHUMICË NË GJILAN**

### **SERBËT**

Para vitit 1999, shumica e serbëve të Gjilanit kanë jetuar në qytet. Mirëpo, një numër i madh i tyre kanë shkuar. Shumica e serbëve kanë vendosur ta braktisin qytetin një kohë të shkurtër pas Luftës së vitit 1999, si pasojë e pasigurisë së përgjithshme. Numri i plotë i serbëve që janë vrarë dhe zhdukur në komunën e Gjilanit pas vitit 1999, është diku rreth 150.

Gjatë trazirave të marsit 2004, shumica e serbëve të mbetur (disa qindra banorë), u bënë shënjestër e sulmeve, dhe në këto ngjarje shumë shtëpi dhe banesa u dogjën dhe u

shkatërruan, gjë kjo e cila rezultoi në një valë të dytë të braktisjes masive të serbëve nga qyteti. Disa nga serbët që e kanë braktisur qytetin më 2004, sot janë duke jetuar në fshatin Shillovë si persona të zhvendosur. Që nga viti 1999 shumica e banesave dhe shtëpive në pronësi të serbëve në Gjilan janë shitur.

Shumica dërmuese e serbëve vazhduan të jetojnë në fshatrat përreth. Kjo zhvendosje demografike nuk është vetëm zhvendosje nga qyteti për në fshatra, por, po ashtu, edhe nga rajoni, edhe pse kjo ndodh në një masë të madhe edhe për shkak të arsyeve ekonomike. Për shembull, gjatë dy viteve të fundit, diku rreth 500 veta kanë shkuar në vendet skandinave (kryesisht në Norvegji).

Një numër i madh serbësh punojnë në bujqësi. Toka është shumë e plleshme, mirëpo përfitimi që mund të arrihet është i vogël. Ka çështje që kanë të bëjnë me perceptimet e sigurisë që po ashtu ndikojnë në punimin e ngastrave që janë larg nga fshatrat serbe. Pos kësaj, një herë pasi që produktet të prodhohen, është tejet e vështirë që ato të shiten, meqë nuk ka treg për këto produkte bujqësore (të mirat që prodhohen në bujqësi vështirë që shiten në Kosovë, ndërkaq, shteti serb nga këta fshatarë kërkon t'i paguajnë doganat për shitjen e produkteve të tyre në Serbi).

Pos angazhimit në bujqësi, serbët marrin ndihma nga buxheti i Serbisë, ndërkohë që rreth 350 prej tyre rrogat i marrin nga buxheti i Kosovës. Është vështirë të thuhet se sa shfrytëzues marrin ndihma nga buxheti i Republikës së Serbisë. Këta janë kryesisht serbë që punojnë në institucionet edukative dhe shëndetësore, ish të punësuar të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe shtetërore, të cilët sot janë duke e marrë pagë minimale, si dhe shfrytëzuesit e benefiteve për fëmijë dhe të atyre sociale. Pos kësaj, ashtu siç u përmend më heret, janë edhe 41 serbë që punojnë në Komunën e Gjilanit, njësoj si rreth 50 që janë të punësuar në institucionet paralele serbe, si komunale, ashtu edhe rajonale.

## **TURQIT**

Numri i turqve që jetojnë në komunën e Gjilanit është përafërsith 1.000. Ky komunitet etnik është në tërësi i integruar në shoqërinë kosovare. Turqit kanë patur gjithnjë liri të lëvizjes. Ata u qasen lirshëm të gjitha institucioneve dhe kompanive publike të Kosovës. Në të njëjtën mënyrë si edhe Komuna, edhe kompanitë publike në faturat e tyre i shkruajnë emrat në turqisht, edhe pse, duke e shfrytëzuar ortografinë dhe gramatikën shqipe. Kjo ka qenë një çështje që nga regjistrimi i vitit 2001, kur OSBE-ja është informuar rreth shkrimit jo të drejtë të emrave turq. Pas reagimit të OSBE-së, gabimet janë ndrequr. Mirëpo, shërbyesit civilë ende i bëjnë të njëjtat gabime. Arsyetimi i tyre është që problemi është i natyrës teknike, dhe që ata s'kanë se ç'të bëjnë lidhur me këtë. Kjo është mjaft alarmuese, duke e patur parasysh që sipas qytetarëve turq, gjatë

zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe lokale, në qytet nuk ka qenë madje as edhe një informatë e vetme që do të ishte e shkruar në turqisht. Nuk ka patur fleta të votimit, dhe as udhëzime votuese, të shkruara në turqisht. Në vetë qytet, është e pamundur të shihet ndonjë reklamë, informatë, apo ftesë në gjuhën turke.

Kur kanë nevojë, pjesëtarët e komunitetit turk në Gjilan i vizitojnë institucionet shëndetësore nën juridiksionin e Qeverisë së Kosovës, ku ata komunikojnë me doktorët në shqip, meqë ata dinë ta flasin shqipen, ndërkohë që shumica e shqiptarëve nuk dijnë të flasin turqisht. Turqit në Gjilan po ashtu i shfrytëzojnë disa media lokale që emetojnë programe në turqisht. Meqë pjesëtarët e bashkësisë turke dijnë shqip, ata po ashtu i shfrytëzojnë mediat në shqip. Numri i pjesëtarëve të komunitetit turk që punojnë në komunën e Gjilanit është më pak se 10, dhe një numër i vogël i tyre po ashtu punon në kompanitë publike.

## **ROMËT**

Janë disa dhjetra romë që jetojnë në lagjen Abdullah Presheva të Gjilanit. Të gjitha familjet rome janë larguar pas qershorit 1999, por ata filluan të kthehen në vitin 2002. Të gjithë romët e Gjilanit flasin serbisht, dhe shumica prej tyre dijnë ta flasin edhe shqip. Qytetrët romë e kanë lirinë e plotë të lëvizjes anembanë Kosovës, dhe ata e shfrytëzojnë gjerësisht transportin publik. Ata nuk kanë ankesa rreth punës së Shërbimit Policor të Kosovës. Për shkak të numrit të rritur të vjedhjeve në lagjen Abdullah Presheva, SHPKja ka organizuar patrollime, me kërkesën e komunitetit rom.

Romët i vizitojnë lirshëm institucionet komunale dhe qarkun, por ata nuk mund ta shfrytëzojnë aty gjuhën amtare në komunikim me shërbyesit civil, meqë ata nuk dinë ta flasin gjuhën rome. Përkthyes për gjuhën rome nuk ka. Asnjë nga informatat në tabelat e shpalljeve në komunën e Gjilanit nuk është në gjuhë rome. E tërë informata është ekskluzivisht në shqip dhe/ose në serbisht. Kësisoj, në komunikimin me shërbyesit civil, romët e shfrytëzojnë ose gjuhën serbe, ose atë shqipe, dhe përgjigjet që i marrin janë në gjuhën në të cilën e kanë bërë kërkesën.

Shumica e romëve të Gjilanit shkojnë në shkollat serbe ku serbishtja është gjuhë e mësimdhënies. Asnjë nga lëndët në asnjërën nga shkollat nuk jipet në gjuhën rome.

Romët i shfrytëzojnë në një masë të njëjtë shërbimet që ofrohen nga institucionet shëndetësore nën juridiksionin e Qeverisë së Serbisë, dhe të atyre nën juridiksionin e Qeverisë së Kosovës. Doktorër janë të sjellshëm ndaj qytarëve romë në të gjitha institucionet në të cilat ata e kanë zakon të shkojnë. Megjithatë, për shkak të

shtrëngimeve financiare, romët rëndom shkojnë në klinikat shëndetësore serbe, meqë aty nuk kanë nevojë të paguajnë për ekzaminimet mjekësore. Nganjëherë, madje edhe shërbyesit civilë që punojnë për klinikën për pacientë të jashtëm në Gjilan nuk kërkojnë pagesa nga romët që marrin ndihmë sociale.

Romët mund të sigurojnë informata rreth veprimtarive komunale apo rreth vendeve të punës nga tabelat e shpalljeve në ndërtesën e komunës. Shumica e qytetarëve romë janë të papunë dhe marrin ndihmë sociale që shkon nga 35 deri në 65 €. Përfaqësuesit romë janë para së gjithash të brengosur për ruajtjen e identitetit rom. Sipas tyre, Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve nuk zbatohet fare në rastin e popullatës rome, meqë gjuha rome nuk është gjuhë zyrtare në asnjërin nga komunat. Pos kësaj, meqë nuk ka shkollë ku romët do të mund t'i ndiqnin lëndët në gjuhën rome, ata duhet të shkojnë në shkollat nën jurisdiksonin e Qeverisë së Kosovës, kur lëndët mbahen në shqip, apo në shkollat nën jurisdiksonin e Qeverisë së Serbisë, kur lëndët mbahen në serbisht. Rrjedhimisht, romët e ndjejnë rrezikun e humbjes së identitetit të tyre kulturor.

## **PËRDORIMI I GJUHËVE NË KOMUNË**

Sa i përket dy gjuhëve kryesore (shqip dhe serbisht), në Gjilan është tendenca për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në tërësi. Duhet theksuar që, më 14 maj 2007, Kuvendi Komunal i Gjilanit mori vendim që gjuha turke të jetë një gjuhë zyrtare e komunës, krahas shqipes dhe serbishtes. Ky vendim duket se është, thjesht, formal, meqë nuk ka patur masa shtesë për jetësimin e tij në praktikë. Administrata komunale nuk ka përkthyes zyrtar për gjuhën turke, dhe shpjegimi i dhënë është që komuna nuk ka fonde të mjaftueshme për ta punësuar ndonjë. Në të njëjtën kohë, institucionet në nivelin qendror dokumentet e tyre i përcjellin të shkruara ekskluzivisht në shqip, e cila punën e përkthimit e bën edhe më të vështirë.

Dokumentet, vendimet, konkluzionet, rregulloret dhe doracakët e brendshëm, dhe rezolutat komunale publike, janë të shkruara në gjuhët shqipe dhe serbishte. Shërbyesit civil nuk dinë të flasin turqisht, kështu që turqit komunikojnë me ta në shqip.

Statuti është në shqip, serbisht dhe anglisht. Megjithatë, pjesa më e madhe e informatave të vendosura në stendë është vetëm në shqip. Zyra e Gjendjes Civile i lëshon dokumentet në shqip, serbisht dhe anglisht, në pajtim me formularin i cili është i njëjtë në të gjitha administratat komunale në Kosovë. Kjo Zyre dokumentet në turqisht i lëshon vetëm me kërkesë. Dokumentet që qytetarëve u lëshohen në gjuhën turke nuk janë në pajtim me gramatikën dhe rregullat ortografike turke. Ka parregullsi të caktuara lidhur me

shqiptimin e drejtë të emrave turq në dokumentet e identifikimit personal, të cilat, nëse nuk janë identike me dokumentet në të cilat emrat janë të shqiptuara drejt, kanë nevojë të ndryshohen. Ndërkaq, procesi i ndryshimit të dokumentave kushton 20 €, dhe qytetarët i bartin këto shpenzime vetë, edhe pse gabimet nuk janë bërë nga ta.

Në përgjithësi, Zyra e Gjendjes Civile lëshon dokumente në gjuhën në të cilën klientët i kanë bërë kërkesat e tyre. Pajisjet për përkthim simultan janë të instaluar. Gjatë sesioneve të Kuvendit Komunal, ofrohet përkthimi në serbisht.

I tërë dokumentacioni publik dhe i brendshëm, me dokumente të tilla si vendimet e kolegjiut të drejtorëve, rezolutat dhe konkluzionet, udhëzimet administrative, rregulloret dhe doracakët e udhëzimeve, jënë të përgatitura dhe të botuara në shqip dhe në serbisht. Dokumente të caktuara, të tilla si strategjitë e ndryshme të zhvillimit, botohen, po ashtu, edhe në anglisht. Shenjat e vendosura në hyrje të ndërtesës komunale, emrat e shërbimeve dhe të punësuarve komunale, informatat, shpalljet e klasifikuara brenda ndërtesës komunale, janë të shkruara në shqip dhe në serbisht. Numri i përkthyesve është i pamjaftueshëm. Shërbimet e përkthimit kanë vëllime të mëdha të materialeve që duhen përkthyer. Zyrtarët komunal nuk i kanë të gjitha kushtet e domosdoshme për punë, dhe për shkak të kësaj klientët nuk i marrin me kohë dokumentet e kërkuara.

Emrat e rrugëve dhe të lagjeve janë të shkruara në shqip dhe në serbisht (edhe pse në disa raste shkrimi në serbisht ishte i mbuluar me sprej), por jo edhe në turqisht, e cila është një nga gjuhët zyrtare të komunës. Vula komunale është në shqip, serbisht dhe në turqisht, ndërkohë që llogoja është e paraqitur me emërtim në gjuhët e sipërpërmendura të cilave iu është shtuar edhe anglishtja. Kohëve të fundit është ripunuar uebsajti komunal, dhe sa i përket informatave të përfshira, ky është shembullor. Fatkeqësisht, në sajë të asaj që zyrja për marrëdhënie me publikun duket sikur nuk ka personel të mjaftueshëm për t'u marrë me dosjet jashtë mase të shumta, kështu që nuk e ka ndonjë person i cili do të merrej vetëm me vendosjen e të dhënave të reja në ueb, përkthimi i ueb-sajtit në anglisht dhe në serbisht është duke marrë më tepër kohë, dhe mbetet në ndërtim e sipër. Nuk ka ndonjë pjesë të uebit e cila është në turqisht.

## **PËRDORIMI I GJUHËVE NË NDËRMARRJET NË PRONËSI PUBLIKE**

Duke e ndjekur një metodologji të ngjashme me atë të hulumtimit paraprak, janë bërë një varg intervistash me zyrtarët e marrëdhënies me publikun në kompanitë publike që veprojnë në Gjilan. Qëllim i këtyre intervistave ishte të vlerësohet shkalla deri në të cilën kompanitë publike punësojnë pjesëtarë të komuniteteve pakicë, të konstatohet numri i të



punësuarve nga pakicat, mundësitë e tyre për t'i përdorur gjuhët e tyre amtare në vendin e punës, si dhe për ta konstatuar marrëdhënien midis kompanive publike dhe të shfrytëzuesve përfundimtarë të shërbimeve të tyre (d.m.th., atë se në cilën gjuhë janë faturat, kontratat dhe informatat e tjera të lëshuara).

Karakteristika kryesore e të gjitha kompanive publike kombëtare në Kosovë është struktura e tyre e centralizuar. Administrata e këtyre kompanive është e vendosur në Prishtinë. I tërë dokumentacioni (për shembull, kontratat e punësimit) është i përgatitur nëpër Selitë Qendrore. Procedurat e punësimit dhe të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me punësimin e punëtorëve të rinj janë të bëra në zyrat kryesore të selive qendrore të kompanive, pavarësisht nga ajo se ku do të punojnë këta punëtorë të rinj, d.m.th., në zyrat qendrore, apo në qendrat rajonale të kompanive.

Pllakat me emrat e kompanive të vendosura në hyrjet e qendrave rajonale të PTK-së (Post Telekom i Kosovës) në Gjilan janë të shkruara në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Kontratat e punësimit për të punësuarit serbë janë të shkruara në gjuhën serbe. Kontratat e punësimit për boshnjakët dhe turqit janë të shkruara në shqip. Përkthimi simultan bëhet në takimet që përcillen nga serbët. Dokumentacioni që i lëshohet konsumatorëve, faturat, kontratat për pagesën e borxheve, dhe kërkesat për linjat e reja telefonike, janë të lëshuara në gjuhën shqipe dhe serbishte. Libri i Rregullave dhe ai i Procedurave të Punës, janë të shkruara në dy gjuhët e sipërpërmendura. Mirëpo, dokumentacioni i brendshëm, informatat në stenda të ndërtesave të PTK-së, emrat e punëtorëve dhe të departamenteve, janë të shkruara që të gjithat në shqip. Qendra rajonale e PTK-së në Gjilan i mbulon komunat e Gjilanit, Kamenicës dhe të Vitisë.

PTK-ja i shpall vendet e lira të punës në gazetat ditore në shqip dhe serbisht. Uebajti i PTK-së është në gjuhët shqipe, anglishte dhe serbishte. Ky ripërtërihet në që të trija këto gjuhë. Komunikimi midis kolegëve bëhet lirshëm në të gjitha gjuhët. Të punësuarit e PTK-së konsumatorëve u përgjigjen në gjuhën në të cilën ata u janë drejtuar.

Pllakat me emrin e kompanisë të vendosura në hyrjet e qendrave rajonale të KEK-ut në Gjilan (Korporata Energjetike e Kosovës) janë të shkruara në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Kontratat e punësimit për të punësuarit serbë janë të shkruara në gjuhën serbe. Kontratat e punësimit për boshnjakët dhe turqit janë të shkruara në shqip. Qendra rajonale e KEK-ut për komunat e Gjilanit, Kamenicës dhe të Vitisë, ndodhet në Gjilan.

Vendet e lira të punës KEK-u i shpall në gazetat ditore në gjuhët shqipe dhe serbishte. Uebajti i KEK-ut është në gjuhët shqipe, anglishte dhe serbishte, dhe ky ripërtërihet në të trija këto gjuhë. Komunikimi midis kolegëve zhvillohet lirshëm në të gjitha gjuhët, dhe

të punësuarit e KEK-ut përgjigjet për shërbimet, konsumatorëve ua japin në gjuhën në të cilën ata u janë drejtuar.

SHUKOS është një asociacion i kompanive rajonale përgjegjëse për ujësjellësat dhe për kanalizimet në Kosovë. Kjo kompani është themeluar me Dekretin e UNMIK-ut Nr. 1999/22:25. Pjesë të SHUKOS-it janë kompanitë në vijim: Ujësjellësi i Prishtinës, Ujësjellësi i Mitrovicës, Ujësjellësi Hidrodrini – Pejë, Hidrosistemi i Radoniqit, Hidrorajoni Jugor i Prizrenit, Bifurkacioni i Ferizajit, dhe Hidromorave e Gjilanit. SHUKOS-i i bashkon të gjitha kompanitë anëtare, i çon përpara interesat e tyre të përbashkëta dhe këto kompani anëtare i këshillon lidhur me punën e tyre. Kompanitë e ujësjellësave dhe të kanalizimeve të punësuarve të tyre ua lëshojnë kontratat e punësimit në shqip dhe në serbisht. Zyra Kryesore e kompanisë së Ujësjellësit të Hidromoravës është në Gjilan.

Kjo kompani është përgjegjëse për sistemin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit në komunat e Kamenicës, Vitisë dhe të Gjilanit. Kontratat e punës dhe të gjitha dokumentet e tjera që u lëshohen të punësuarve të komunitetit serb janë në serbisht, dhe edhe komunikimi foljor me ta bëhet, po ashtu, në serbisht. Të punësuarit e komunitetit turk vazhdojnë t'i pranojnë kontratat e tyre të punësimit dhe dokumentacionin tjetër në shqip, meqë nuk e kanë bërë ndonjë kërkesë për t'i marrë ato në gjuhën e tyre amtare.

## REKOMANDIMET

- Autoritetet komunale në Gjiilan duhet t'i përmbushin obligimet që burojnë nga legjislacioni kombëtar dhe komunal në rastin e mos-zgjedhjes së Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete.
- Komuna duhet ta adresojë urgjentisht çështjen e jetësimit të përdorimit të gjuhës turke në administratën komunale dhe në shërbimin civil komunal. Vështirësitë teknike të hasura gjatë shkrimit të emrave turq sipas rregullave të gjuhës turke, duhen identifikuar dhe zgjidhur. Duhet gjendur fonde shtesë për punësimin e numrit të nevojshëm të përkthyesve për zbatimin e duhur të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.
- Komuna duhet t'i shtojë urgjentisht aktivitetet e veta lidhur me takimet publike rreth çështjeve që kanë të bëjnë me pakicat. Pjesëtarët e pakicave duhet të jenë të informuar për të gjitha instrumentet që i kanë në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre.
- Komuna duhet t'i përfshijë përfaqësuesit e pakicave në proceset e vendim-marrjes për mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Këta përfaqësues të pakicave Komuna duhet posaçërisht t'i përfshijë në nivelin e ekzekutivit në procesin vendim-marrës i cili ka të bëjë drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të pakicave, të tilla si liria e lëvizjes, e drejta për përdorimin e gjuhëve, për edukimin në gjuhët amtare dhe e punësimit.
- Komuna, në bashkëpunim me Qeverinë qendrore, duhet të përpiqet të bëjë përpjekje shtesë për përmirësimin e pozitës së komuniteteve lidhur me të drejtat e pakicave të Kosovës për punësim në ndërmarrjet në pronësi private.
- Sa i përket edukimit, Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Qeverisë së Kosovës (MASHT), duhet t'i zhvillojë, për nevojat e nxënësve serbë, planprogramet për edukim në gjuhën serbe, domethënë, për nxënësit serbë dhe të atyre të minoriteteve që dojnë të edukohen në serbisht. MASHT-i i Kosovës është po ashtu i obliguar që t'i sigurojë tekstet shkollore për nxënësit nga komunitetet pakicë të cilët i ndjekin planprogramet e Qeverisë së Kosovës. Si një motivim shtesë, edhe komunat, në bashkëpunim me MASHT-in mund t'i sigurojnë tekstet shkollore për shkollat fillore.
- Lidhur me vështirësitë në edukim me të cilat është duke u ballafaquar komuniteti rom, MASHT-i duhet, po ashtu, t'i përvetësojë, si një motivim shtesë të fëmijëve nga komuniteti rom të cilët e ndjekin mësimin në sistemin arsimor të Kosovës, planet mësimore për lëndët shtesë që do të organizoheshin për ta, dhe të cilat do t'i trajtonin çështjet që kanë të bëjnë me kulturën dhe trashëgiminë rome: gjuhën, kulturën, historinë rome, etj. Lidhur me këtë, një politikë e ngjashme duhet përvetësuar edhe për komunitetet e ashkalinjëve dhe të egjiptasve. Këto plane

mësimore duhen përgatitur në bashkëpunim me pjesëtarët e komuniteteve përkatëse.

- Qeveria e Kosovës, Qeveria Komunale e Gjilanit, dhe Zyra e Bashkësisë Ndërkombëtare duhet ta mbështesin politikisht decentralizimin dhe krijimin e komunës së Parteshit, dhe duhet ta nxisin pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në zgjedhjet e ardhshme komunale të parapara për 15 nëntor 2009.

**POLITIKAT LOKALE NË KOMUNITETET  
MULTIETNIKE**

***RASTI STUDIMOR: PRIZRENI***

## HYRJE: NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR I KOMUNËS

Prizreni është një qytet që ndodhet në jugun e Kosovës dhe i cili ka tradita të pasura historike. Ky është qendër administrative e komunës me të njëjtin emër. Zona e Prizrenit është një nga shtatë zonat e Kosovës (të cilat janë ndarjet administrative të nivelit më të lartë), me seli në Prizren. Kjo zonë i përfshinë komunat e Prizrenit, të Dragashit, Suharekës, Malishevës dhe të Pilot Njësisë Komunale të Mamushës. Komuna e Prizrenit e ka diku rreth 6% të territorit të tërë të Kosovës, me 640 km<sup>2</sup>. Në sajë të afërsisë së saj me Republikën e Shqipërisë dhe me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, qyteti i Prizrenit e luan një rol të rëndësishëm në bizneset dhe në tregtinë rajonale.

Popullata e vlerësuar e komunës është rreth 240.000 banorë, duke përfshirë këtu vetë qytetin, dhe 76 fshatrat e tij. Pos shumicës së popullatës që përbëhet nga shqiptarë të Kosovës, Prizreni është vend i boshnjakëve të Kosovës (22.000), turqve të Kosovës (9.000 – pa e përfshirë popullatën e turqve të Kosovës që jeton në Pilot Njësinë Komunale të Mamushës), dhe i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve (5.300). Është po ashtu edhe një numër relativisht i vogël i serbëve të Kosovës (166), që jetojnë kryesisht nëpër fshatra, dhe një numër më i vogël i tyre që jetojnë në Prizren (30 veta).<sup>31</sup>

Prizreni njihet për diversitetin e vet etnik dhe e ka një traditë të gjatë të tolerancës dhe të bashkëpunimit ndër-etnik. Ky konsiderohet si komuna më heterogjene në Kosovë për nga aspekti kulturor dhe etnik. Kërcënimi i dhunës me motivime etnike, e cila kishte filluar gjatë dekadës para Luftës së vitit 1999, dhe vazhdoi edhe gjatë dhe pas saj, ekziston ende, mirëpo, megjithatë, gjuha serbe dhe boshnjake fliten lirshëm, si në qytetin e Prizrenit, ashtu edhe në zonat e tjera ku banojnë serbë të Kosovës.

Qyteti i Prizrenit, që nga lashtësia është njohur si një vend unik në Ballkan për vlerat e veta të trashëguara kulturore, qytetërimin dhe fetë e ndryshme. Duke e patur parasysh pozitën e favorshme gjeografike, bashkëshkrirjen harmonike të kulturave të tij gjatë historisë, dhe një numër të lakmueshëm të monumenteve të të gjitha periudhave historike, qyteti i Prizrenit e mban me të drejtë epitetin e “Qytetit Muze,” dhe bën pjesë në mesin e qyteteve më të bukura të Kosovës. I vendosur përgjatë Maleve të Sharrit, të cilat janë shpallur Park Kombëtar, në të dyja anët e lumit të Lumbardhit dhe në një nyje të rrugëve të rëndësishme tregtare midis Lindjes dhe Perëndimit, qyteti i Prizrenit është njohur përgjatë tërë historisë së tij si një qendër jashtëzakonisht e rëndësishme kulturore, ekonomike dhe diplomatike.

Prizreni e ka një histori të gjatë dhe të pasur, duke filluar që nga kohët e lashta, dhe duke e patur gjithnjë një pozitë të veçantë në periudhat e ndryshme historike. Në kohën e mbizotërimit të prodhimit të zejeve, Prizreni u shndërrua në njërin nga qendrat më të mëdha zejtare në Ballkan. Kanë qenë më tepër se 120 zeje që janë ushtruar në punëtori të

---

<sup>31</sup> Zyra Komunale për Komunitete e Prizrenit, tetor 2007.

ndryshme. Të mirat e prodhuara në Prizren janë shitur jo vetëm anembanë tregjeve të Perandorisë Osmane, por edhe më larg. Në mesin e veprimtarive të shumta të artizanatve që janë ushtruar këtu, Prizreni ka qenë në veçanti i njohur për cilësinë dhe traditën e zanateve të përpunimit të metaleve të çmuara. Ky artizanat edhe më tutje mbetet një lloj i “shenjës dalluese” të Prizrenit.

Dëshmi e vlerave të jashtëzakonshme që i ka Prizreni, janë, në mes tjerash, edhe 24 vendet e identifikuar arkeologjike, 39 ndërtesat e krishtera të kultit, 46 ndërtesat fetare islamike, dhe mbi 74 ndërtesat me një arkitekturë të theksuar folklorike. Kështjella, në maje të malit, mbi qytet, Manastiri i të Premtes së Shenjtë, Shën Spasi (Shpëtimi), Koka e Mihael Gabrielit në Manastirin e Engujve, Kisha e Zonjës Shpëtimtare, Hamami Turk, Xhamia e Mehmet Pashës, Xhamia e Sinan Pashës, Ura e Vjetër e Gurit, janë vetëm një pjesë e imtë e trashëgimisë kulturore të Prizrenit.

Falë infrastrukturës kulturore e cila përpiket të jetë në funksion të mbrojtjes, kultivimit dhe prezantimit të kulturës materiale dhe shpirtërore dhe të vlerave të trashëguara, qyteti i Prizrenit e projekton mundësinë e vet në zhvillimin e turizmit, si një veprimtari profitabile ekonomike.

## **KORNIZA LIGJORE KOMUNALE**

Mes tjerash, komuna e Prizrenit i ka kaluar dy dokumente ligjore që, në mes tjerash, i rregullojnë çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë, Statutin e Komunës dhe Rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve.

### **Statuti i Komunës së Prizrenit**

E para nga dispozitat e Statutit të Komunës së Prizrenit që ka të bëjë me çështjet e pakicave është Neni 8 i tij, që gjuhët shqipe, serbishte, boshnjake dhe turqishte i përcakton si gjuhë që duhen vënë në vulën dhe shenjën e Komunës. Të gjitha dokumentet zyrtare të Komunës parashihen të jenë në shqip, në serbisht, në boshnjakisht, dhe në turqisht. Neni 13 e përcakton pjesëmarrjen përpjestimore të pjesëtarëve të pakicave kombëtare në trupat dhe në shërbimet publike komunale të qeverisjes lokale.

Nenet 11 dhe 12 e garantojnë të drejtën e komuniteteve kombëtare për ta shprehur lirshëm identitetin e tyre etnik, kulturor dhe fetar. Pjesëtarët e komuniteteve e kanë të drejtën të komunikojnë në gjuhën e vet me trupat dhe shërbimet civile të Komunës, në pajtim me Ligjin në fuqi dhe me konventat ndërkombëtare. Takimet e Kuvendit

Komunal, të komiteteve të tij, të Bordit të Drejtorëve, dhe të gjitha takimet publike do të bëhen në gjuhët shqipe, serbishte, boshnjakishte, dhe në atë turqishte.

Neni 35 e përcakton postin e Zëvendës Kryesuesit për Komunitete. Kuvendi Komunal (Neni 37) e zgjedh Zëvendës Kryesuesin për Komunitete nga anëtarët e Kuvendit Komunal që u takojnë komuniteteve jo-shumicë, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Ky Zëvendës Kryesues është përgjegjës për trajtimin e ankesave të minoriteteve apo të pjesëtarëve të tyre lidhur me aktet dhe vendimet komunale që mund t'i shkelin të drejtat e tyre të garantuara me kushtetutë. Zëvendës Kryesuesi këto akte dhe vendime ia ofron për shqyrtim Kuvendit Komunal. Nëse këto akte dhe vendime nuk shqyrtohen, apo nëse Zëvendës Kryesuesi konsideron se rezultati i shqyrtimit ende paraqet shkelje të të drejtave kushtetuese, ai mund t'ia përcjellë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Neni 52 i Statutit e themelon postin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete. Emërimi dhe shkarkimi i Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete propozohet nga Kryetari i Komunës dhe duhet të miratohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal të pranishëm që votojnë, dhe nga shumica e anëtarëve të Kuvendit Komunal që i takojnë pakicave që janë të pranishëm dhe që votojnë. Neni 57 e përcakton që Kryetari i Komunës mund ta iniciojë procedurën për shkarkimin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete, kur të ketë shkaqe të arsyeshme për këtë, dhe që procedura në këtë rast do të jetë e njëjtë si ajo në rastin e emërimit.

Neni 58 i Statutit të Komunës së Prizrenit e themelon Komitetin për Komunitete si një komitet permanent të Komunës. Më tutje, Neni 62 e specifikon që Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përpunueshmërisë së autoriteteve komunale me Ligjin, duke i shqyrtuar të gjitha politikat, praktikat dhe veprimtaritë komunale, ashtu që të sigurojë respektimin e plotë të të drejtave dhe të interesave të komuniteteve. Ky Komitet, po ashtu i propozon Kuvendit Komunal masat e domosdoshme për promovimin, shprehjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identiteteve etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore të komuniteteve. Komiteti i Komuniteteve përbëhet nga shumica e thjeshtë e anëtarëve të Kuvendit Komunal, dhe të anëtarëve të tjerë dhe të pjesëtarëve të komuniteteve. Çdo komitet që jeton në komunë përfaqësohet nga të paktën një anëtar.

Dhe, së fundi, Neni 69, për Shërbimin Civil të Komunës, e përcakton që punësimi në këtë shërbim vrojtohet dhe rregullohet nga Kryetari i Komunës, përmes kreut të personelit, dhe e pasqyron përpjesën e duhur të pjesëtarëve të kualifikuar të komuniteteve në të gjitha nivelet e komunës.



## **Rregullorja për Përdorimin e Gjuhëve**

Kjo Rregullore është posaçërisht e rëndësishme për një komunë me shumëllojshmëri linguistike si ajo e cila haset në Prizren. Sipas Nenit 1 të saj, qëllimi i Rregullores për Përdorimin e Gjuhëve të Komunës së Prizrenit është ta sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në punimet e administratës, në institucionet arsimore dhe të shëndetësisë të administruara nga Komuna, dhe në ndërmarrjet publike të themeluara nga Komuna, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Neni 2 e përcakton që gjuhët zyrtare në përdorim të barabartë në të gjitha organet e administratës komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore komunale, dhe në ndërmarrjet publike komunale, janë gjuhët shqipe, serbishte, boshnjakishte dhe turqishte. Nenet 3 – 5 e përcaktojnë barazinë e gjuhëve zyrtare në përdorim në takimet zyrtare, në takimet publike dhe në takimet e tjera të Komunës.

Duke u bazuar në Nenin 6, gjatë komunikimit të tyre me organet e Komunës, qytetarët mund t'i bëjnë kërkesat, dhe ata do t'i marrin përgjigjet, në formë të shkruar apo gojore, në çdonjërin nga gjuhët në përdorim zyrtar në Komunë.

Në këtë Rregullore të shkurtër (3 faqe), janë, më tutje, Neni 7, që e përkufizon përdorimin e gjuhëve në komunikimin e Komunës me komunat e tjera, si dhe Neni 8, rreth përdorimit të gjuhëve në emrat dhe në shenjat zyrtare, dhe, edhe 3 dispozita të tjera përfundimtare.

Rregullorja për Përdorimin e Gjuhëve, e Komunës së Prizrenit nuk është në pajtim të plotë me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, në Nenin e saj 6. Teksti i këtij neni është si në vijim: “Gjatë komunikimit me organet e institucioneve të përmendura në Nenin 2 të kësaj Rregulloreje, qytetarët-palët, mund ta përdorin, dhe do të marrin përgjigje, në të shkruar apo gojarisht, në çdo gjuhë e cila është në përdorimin zyrtar në territorin e Komunës së Prizrenit. Gjuhë e palës do të konsiderohet gjuha e përdorur në kërkesën fillestare të bërë Komunës (organeve, institucioneve, dhe ndërmarrjeve lokale).” Në këtë mënyrë, Neni 6 e përcakton barazinë e gjuhëve në përdorim zyrtar në Komunë, në pajtim të plotë me Nenet 7.1 – 7.4 të Ligjit mbi Përdorimin e Gjuhëve.

Megjithatë, Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve, në Nenin e vet 8.4, e përkufizon edhe një barazi tjetër, atë të gjuhëve që nuk janë gjuhë zyrtare në një komunë. Sipas këtij Neni 8.4 të Ligjit, gjuhët që nuk janë në përdorim zyrtar në Komunë, mund të përdoren lirshëm nga pjesëtarët e komuniteteve përkatëse, në punimet dhe takimet komunale, dhe pajisjet për përkthim duhet të vehen në dispozicion sa herë që ato të kërkohen. Dokumentet e

dorëzuar nga pjesëtarët e tillë do të përkthehen në gjuhët zyrtare, dhe përgjigjet do të jepen në gjuhën origjinale.

Kësisoj, Neni 6 i Rregullores, ndërkohë që e njëj barazinë e gjuhëve zyrtare në komunë, e cila është në pajtim të plotë me Ligjin, dështon që ta njohë barazinë e gjuhëve që nuk janë zyrtare në komunë, me ato zyrtaret, një barazi kjo e cila është po ashtu e garantuar me Ligj.

## **PJESËMARRJA POLITIKE**

Rezultatet e zgjedhjeve lokale të nëntorit 2007 kanë sjellë zhvendosje përmbajtësore në pamjen politike të komunës së Prizrenit. Gjatë dy mandateve paraprake, Komuna e Prizrenit ishte udhëhequr nga LDK-ja. Mirëpo, si pasojë e ngjarjeve të fundit në këtë parti (vdekja e Presidentit Rugova, çarja e madhe, dhe krijimi në vijim i LDD-së nga njëri nga fraksionet që u shfaqën si pasojë), në zgjedhjet e nëntorit 2007 LDK-ja nuk ia doli t'i përsëriste arritjet e veta nga periudha paraprake, dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e fitoi kuvendin komunal dhe zgjedhjet për kryetar të komunës.

Kryetar i Komunës së Prizrenit është zgjedhur Mr. Ramadan Muja, ndërsa në zgjedhjet për Kuvendin Komunal PDK-ja i fitoi 11 ulëse, LDK-ja 10, AKR-ja 4, KTDP-ja 3, VAKAT-i 3, LDD-ja 2, ORA 2, AAK-ja 2, SDA-ja 1 dhe PD-ja 1. Pjesëmarrja politike e komuniteteve pakicë në procesin zgjedhor në Komunën e Prizrenit ishte jashtëzakonisht e lartë. Si pasojë, komunitetet pakicë janë të përfaqësuara me 7 nga 41 ulëset në Kuvendin Komunal.

Në Komunën e Prizrenit komunitetet pakicë janë pjesë e qeverisë së koalicionit, që përbëhet nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Partia Demokratike Turke e Kosovës (KTDP), Koalicioni Boshnjak VAKAT dhe Partia Reformiste ORA.

## **INSTITUCIONET KOMUNALE PËR KOMUNITETET**

Komuna e Prizrenit i ka funksionale të gjitha institucionet dhe postet në pajtim me ligjin kombëtar dhe komunal. Postin e Zëvendës Kryetarit të Komunës për Komunitete e mban z. Ercan Shpat i Partisë Demokratike Turke (KTDP). Po ashtu, Zëvendës Kryesues i Kuvendit Komunal për Komunitete është z. Cemal Kurtisi i Koalicionit Boshnjak VAKAT. Edhe KTDP-ja, edhe VAKAT-i, janë pjesë e koalicionit qeverisës komunal.

Kuvendi Komunal e ka themeluar Komitetin për Komunitete. Komiteti i ka njëmbëdhjetë anëtarë, gjashtë prej të cilëve vijnë nga komunitetet pakicë. Anëtarët e komuniteteve pakicë të këtij Komiteti vijnë nga komunitetet turke, boshnjake, serbe, rome, ashkalinje, dhe egjiptase. Komiteti është tejet aktiv. Në gjysmën e parë të vitit, ky Komitet i ka mbajtur pesë mbledhje.<sup>32</sup>

Komuna e Prizrenit e ka po ashtu edhe Zyren për Komunitete. Kjo Zyre udhëhiqet nga z. Alija Ajradini i komunitetit boshnjak. Zyrtarët e kësaj zyre vijnë nga të gjitha komunitetet pakicë të Komunës së Prizrenit. Të drejtat, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyres për Komunitete kanë qenë të përkufizuara nga Rregullorja e UNMIK-ut 2007/30 e cila ka pushuar të jetë në fuqi me hyrjen në fuqi të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale më 16 qershor, 2008. Zyra për Komunitete është një pjesë integrale e komunës dhe e strukturës administrative komunale, dhe Kreu i Zyres së Komunitete është një ex-officio anëtar i Bordit të Drejtorëve të Komunës. Kjo Zyre është përgjegjëse për rritjen e të drejtave të komuniteteve, dhe për sigurimin e qasjes së barabartë të komuniteteve në shërbimet publike në nivelin komunal.

Para shpalljes së Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, zyret e komuniteteve nëpër komunat anembanë Kosovës kanë qenë në veprim e sipër, dhe ato nganjëherë, si në rastin e Komunës së Prizrenit, funksiononin me një sukses të konsiderueshëm. Tash, këto zyra nuk janë të kërkuara me Ligj – por, në të vërtetë, këto as nuk janë të ndaluara, kështu që këto vazhdojnë të ekzistojnë dhe të funksionojnë, edhe përkundrajt faktit që pozita e tyre tash është e papërcaktuar.

Zyra për Komunitete e Komunës së Prizrenit kohëve të fundit ka shfaqur një përkushtim më të madh ndaj përmirësimit të mirëqenies së grupeve të romëve, ashkalinjëve, dhe të egjiptasve (RAE) në kuadër të territorit të vet. Këto tri komunitete janë të shkapërderdhura në tri lagje: Terzimahallë (shumica romë), Jeta e Re (ashkalinjtë) dhe Edit Durham (egjiptas). Me qëllim që të ndërmerren hapa konkretë drejt përmirësimit të jetës të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve, komuna ka organizuar një varg takimesh të përpiluara ashtu që qeverisja lokale të ketë rast që nga afër t'i dëgjojë dhe analizojë nevojat, kërkesat, brengat dhe problemet me të cilat komunitetet RAE përballen sot, posaçërisht lidhur me infrastrukturën e dobët, ujësjellësin, ndriçimin rrugor, programet parashkollore, arsimimin dhe papunësinë.

Komuna e Prizrenit e ka një numër të tërësishëm prej 311 të punësuarish, ku 13 janë emëruar politikë, dhe 298 janë shërbyes civilë. Në nivelin politik, nga 13 të punësuarit 11 (84,61%) janë pjesëtarë të komunitetit shumicë dhe 2 (15,39%) janë nga komunitetet pakicë. Në shërbimin civil, nga numri i tërësishëm prej 298 të punësuarve, 244 (81,88%) janë pjesëtarë të komunitetit shumicë, ndërsa 54 (18,12%) prej tyre u takojnë komuniteteve pakicë: 26 (8,72%) janë boshnjakë, 22 (7,38%) janë turq, 5 (1,68%) janë

---

<sup>32</sup> Raporti i funksionimit të Komunave të Republikës së Kosovës, Janar – Qershor 2009, Ministria e Administritimit të Pushtetit Lokal, Korrik 2009, f.73.

romë dhe 1 (0,34%) është goran. Komuna e Prizrenit e ka funksionale njësinë e përkthimit e cila i përmbush nevojat e administratës komunale.

## **EDUKIMI SI SFIDË**

Legjislacioni i zbatuar në Kosovë ofron të drejta gjithëpërfshirëse dhe të veçanta edukative për komunitetet jo-shumicë (Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të Tyre në Kosovë, që ka hyrë në fuqi më 16 qershor 2008). Këto e përfshijnë të drejtën për të fituar edukim publik në të gjitha nivelet në ndonjë nga gjuhët zyrtare (shqip dhe serbisht). Në zonat e banuara me komunitete gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit që i takojnë këtyre komuniteteve e kanë të drejtën të fitojnë edukim parashkollor, fillor dhe të mesëm publik në gjuhën e tyre amtare.

Aty ku, në saje të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve, apo të shkaqeve të tjera, edukimi në gjuhën e zgjedhur zyrtare apo të komunitetit nuk ofrohet, duhen garantuar alternativa. Dispozitat ligjore më tutje e njohin të drejtën e komuniteteve për të ngritur struktura private edukative dhe aftësuese dhe për të krijuar module edukative rreth kulturës, historisë dhe traditave të tyre.

Kësisoj, legjislacioni i Kosovës e njeh të drejtën për të fituar edukim publik në të gjitha nivelet në gjuhët e zgjedhura zyrtare, dhe të drejtën për të fituar edukim parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhët e tjera të komuniteteve tradicionale të Kosovës në ato komuna ku këto komunitete jetojnë. Në praktikë, në komunën e Prizrenit, nxënësit boshnjakë dhe turq të Kosovës kanë qasje në edukimin në gjuhën amtare, por nuk ka libra në gjuhët e tyre për edukimin e mesëm dhe, nganjë herë, edhe për edukimin fillor. Komunitetet RAE nuk kanë qasje në lëndët edukative të veçanta për komunitetin që do t'a mundësonin ruajtjen e identitetit të tyre. Cilësia dhe disponueshmëria e planprogrameve dhe e teksteve shkollore për komunitetet jo-shumicë varet nga gjuha e komunitetit jo-shumicë, domethënë, serbishtja, boshnjakishtja dhe turqishtja.

Planprogrami kornizë i Kosovës është i ndarë në lëndët e përgjithshme dhe në lëndët "kombëtare," të veçanta për komunitetin. Këto lëndë janë gjuha, historia, arti dhe muzika. Lëndët kombëtare për turqit dhe për boshnjakët e Kosovës janë zhvilluar nga ekspertët e komuniteteve përkatëse. Planprogramet dhe tekstet shkollore për lëndët e përgjithshme janë të përgatitura nga ekspertët kosovarë dhe më pastaj janë të përkthyer në turqisht dhe boshnjakisht. Në të dyja rastet, përkthimi shpesh herë konsiderohet se nuk është i cilësisë më të mirë. Ligji për Edukimin Fillor dhe të Mesëm e obligon Ministrinë e Edukimit për ta siguruar disponueshmërinë pa pagesë të teksteve shkollore për të gjitha klasat (1-9) e edukimit të detyrueshëm (Pjesa 3.2 (b), Ligji për Edukimin Fillor dhe të Mesëm).

Ministria, në bashkëpunim me komunat, është po ashtu përgjegjëse për t'u ofruar nxënësve tekstet shkollore të duhura "në gjuhët e tyre amtare." Që nga viti 2008, Ministria e Arsimit ka qenë duke ofruar tekste shkollore falas për fëmijët e shkollës fillore. Kushtet e dobëta ekonomike i bëjnë, po ashtu, kostot arsimore të papërballueshme për nxënësit ashkalinjë të këtij rajoni, duke rezultuar në mosregjistrimin dhe në braktisjen e arsimit. Ata rëndom mbështeten në donacionet e teksteve shkollore dhe në përkrahjet e tjera të Ministrisë së Arsimit, të organizatave ndërkombëtare apo të dhuruesve privatë.

Mungesa e teksteve shkollore të bazuara në planprograme e ndikon seriozisht cilësinë e edukimit në gjuhën amtare në gjuhët boshnjake dhe turke. Nuk ka (për edukimin e lartë sekondar, klasët 10-13), apo ka fare pak (për edukimin e ulët sekondar, klasët 6-9), libra të bazuar në planprogramet në këto gjuhë. Në vitin shkollor 2008/9, nxënësit në gjuhën boshnjake dhe turke, nga Ministria e Arsimit kanë marrë vetëm grumbuj jokomplet të teksteve shkollore falas për klasët 1-5. Edhe pse Ministria e Arsimit investoi 200.000 € në vitin 2008/9, disa nga librat në boshnjakisht dhe turqisht nuk ishin në dispozicion. Për shembull, në Prizren, deri në tetor 2008, nuk ishin në dispozicion tekstet shkollore vijuese për lëndët kombëtare: Alfabeti Boshnjak (klasa 1), Libër Leximi i Gjuhës Boshnjake (klasat 4-5), Arti Boshnjak (klasat 3 dhe 5), Muzika Boshnjake (klasët 3-5), Tekst i Librit të Leximit në Turqisht (klasa 5). Po ashtu nuk është në dispozicion teksti i Muzikës Turke, dhe në Kosovë nuk është botuar ndonjë tekst i Librit të Leximit në Turqisht. Pos kësaj, në Prizren kanë munguar edhe librat e lëndëve të përgjithshme: Matematika (klasët 3 dhe 5), Puna Praktike (klasa 5), Natyra (klasa 5), dhe Edukimi Qytetar (klasa 5) në turqisht, dhe Matematika (klasët 1,2 dhe 5), Natyra dhe Edukimi Qytetar (klasa 5) në gjuhën boshnjake.

Në qytetin e Prizrenit, nxënësit turq të Kosovës kanë qasje në edukimin fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre amtare. Lëndët e Gjuhës Turke jipen në Prizren (Fakulteti i Edukimit) dhe në Prishtinë (Fakulteti i Filologjisë). Megjithatë, shumë nga tekstet shkollore ende nuk janë të disponueshme, duke krijuar kështu një disavantazh në raport me nxënësit shqiptarë të Kosovës, në veçanti sa i përket provimeve pranuese për shkollat e mesme dhe për arsimim të lartë. Studentët shpesh herë shfrytëzojnë libra të importuar nga Turqia, dhe, në disa raste, shënimet e shkruara në klasë të nxjerra nga mësuesit. Pjesa më e madhe e kohës së mësimi shfrytëzohet për mësim dhe diktim, gjë kjo e cila rëndom perceptohet si e paragjykuar ose jokonsistente me planprogramet, dhe nuk krijon mundësi për ndërveprim përmes pyetjeve nga nxënësit.

Sa i përket personelit mësimdhënës, bazuar në legjislacionin ekzistues, autoritetet kanë obligim të sigurojnë disponueshmërinë e një personeli të kualifikuar për aftësimin e kandidatëve që janë duke u përpjekur të bëhen mësues në gjuhët e komuniteteve. Aftësimi duhet të kryhet në gjuhët e komuniteteve dhe kandidatët e përzgjedhur duhet të jenë ose folës që gjuhën e komunitetit e kanë amtare, ose folës të kualifikuar të saj. Më tutje, Ministria e Edukimit dhe komunat duhet të sigurojnë që krerët dhe mësimdhënësit

e institucioneve edukative publike, që veprojnë në gjuhët e komuniteteve, të jenë kryesisht përfaqësues të atyre komuniteteve apo të jenë të afërt me identitetin e komunitetit përkatës.

Në praktikë, nuk ka përfaqësim të mjaftueshëm të komuniteteve jo-shumicë në pozitat drejtuese të shkollave. Sistemi edukativ ofron deri në një masë aftësim në gjuhën amtare për mësimdhënësit e gjuhëve turke dhe boshnjake, por aftësimi në lëndët e specializuara është në dispozicion vetëm në shqip. Nuk ka aftësim të veçantë që ofrohet për mësimdhënësit e gjuhës rome në gjuhën e tyre. Është një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve të nën-kualifikuar në sistemin e planprogrameve të Kosovës, ndërsa numri i mësimdhënësve të gjuhëve turke dhe boshnjake në disa shkolla është i pamjaftueshëm.

Qasja në edukimin e lartë është e domosdoshme për ta mundur aftësimin e një numri të mjaftueshëm të mësimdhënësve nga të gjitha komunitetet. Legjislacioni i zbatuar ofron mundësi për qasje të barabartë në edukimin universitar, përfshirë këtu masat e veçanta për ta siguruar pranimin e kandidatëve nga të gjitha komunitetet. Mirëpo, në praktikë, në Kosovë është një brez i kufizuar i mundësive për arsimim të lartë në gjuhët jo-zyrtare. Universiteti i Prishtinës i ofron disa lëndë të gjuhës boshnjakishte dhe turqishte në Filologjinë Turke (50 vende), në Gjuhën Boshnjake dhe Turke për Mësimdhënës (nga 35 vende për çdonjërin), në Teknologjinë Informatike në Boshnjakisht (35 vende) dhe në Administrimin e Biznesit në Boshnjakisht (80 vende).

Në Prizren, mësimdhënësit boshnjakë, ashkalinjë dhe egjiptas të Kosovës marrin pjesë në trajnimet e mbështetura nga Ministria e Arsimit. Trajnimi rëndom bëhet në shqip (dhe në disa raste në boshnjakisht). Në rastin e parë, ofrohet edhe përkthimi, por disa nga ata që marrin pjesë janë të pakënaqur me cilësinë e tij. Sesionet e trajnimit për mësimdhënësit turq të Kosovës sponsorohen nga Ministria e Arsimit dhe Qeveria e Turqisë, dhe ofrohen në shqip me përkthim simultan. Mësimdhënësit e theksojnë atë që trajnimi do të ishte në një mënyrë përmbajtësore më i mirë po të jipej drejtpërdrejt në turqisht. Përafërsisht 90 për qind të mësimdhënësve turq të Kosovës në Prizren i kanë përgatitjet dhe kualifikimet e duhura akademike.

Pozitat drejtuese nëpër shkolla mbahen kryesisht nga përfaqësuesit e komunitetit përkatës shumicë. Komunitetet RAE janë të nën-përfaqësuar në mesin e mësimdhënësve, dhe nuk janë të përfaqësuar fare në nivelin drejtues të shkollave. Komuniteteve të boshnjakëve dhe të turqve të Kosovës ju mungon një përfaqësim i mjaftueshëm në kuadër të shkollave me gjuhë të përziera. Në qytetin e Prizrenit, vetëm një nga gjashtë shkollat fillore që ofrojnë edukim në gjuhën turke, ka zëvendës-drejtor i cili është turk i Kosovës. Asnjë nga katër shkollat e mesme të Prizrenit që ofrojnë edukim në turqisht nuk ka drejtues që është turk i Kosovës. Nga ana tjetër, ato kanë pozita drejtuese shkollore ku edukimi zhvillohet në gjuhët jozyrtare. Në shkollat njëetnike

boshnjake të luginës së Zhupës, mësimdhënësit dhe drejtuesit i takojnë komunitetit boshnjak të Kosovës.

Nëse edukimi në gjuhën e zgjedhur zyrtare, apo në gjuhën e komunitetit vendës nuk është në dispozicion, Nenet e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve (Neni 19.4) dhe të Ligjit për të Drejtat e Komuniteteve (Neni 8.2), e parashohin që 'Mësimdhënësit udhëtues janë mësues që udhëtojnë dhe japin edukim në gjuhën amtare për grupet e vogla të nxënësve që jetojnë në vende të ndryshme. Ofertat e konvikteve do të sigurojnë që fëmijë për të cilin edukimi në gjuhën amtare nuk është në dispozicion në komunën e vendndodhjes mund ta ndjek këtë edukim në ndonjë vend tjetër ku shpenzimet e konviktit dhe të qirasë do të paguhet nga Qeveria e Kosovës apo nga Komuna e vendndodhjes.' Në praktikë, aty ku edukimi në gjuhën amtare nuk është në dispozicion, zgjidhet alternative kryesisht kufizohen në arranzhimet e transportimit.

Në mungesë të masave dhe udhëzimeve konkrete qendrore, nismat aktive për sigurimin e integritetit edukativ të nxënësve të cenusur të komuniteteve RAE, të tilla si ndikimi potencial i bursave edukative që do të përdoren për nxënësit e këtyre komuniteteve, duhen vlerësuar më tutje, posaçërisht sa i përket përfundimit të edukimit fillor dhe të mesëm dhe qasjes në edukimin terciar.

Në vijim të programit të viteve 2004-2007 për lëndët shtesë që i kanë patur si synim rreth 1.800 fëmijë të komuniteteve RAE në nëntë komuna të Kosovës, përfshirë edhe Prizrenin, nevoja për masat e qëndrueshme për ta siguruar integritetin e nxënësve RAE është e njohur në strategjinë shumëvjeçare të Ministrisë së Arsimit.

Në Prizren, ku nxënësit romë, ashkalinjë dhe egjiptas, dhe në veçanti vajzat, janë viktimë e shkallëve të ulëta të regjistrimit dhe të shkallëve të larta të braktisjes, kryesisht në sajë të gjendjes së rëndë ekonomike, komuna ka organizuar fushata për vetëdijësimin publik, të cilat i nxisin prindërit për t'i regjistruar fëmijët e tyre nëpër shkollë. Duke synuar në përkrahjen e integritetit edukativ përmes qasjes së forcuar në edukimin parashkollor, në nëntor 2008, Caritasi zviceran dhe Komuna e Prizrenit i kanë themeluar bashkarisht dy objekte edukative parashkollore ku gjysma e personelit i takon komunitetit rom. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka ofruar bursa për nxënësit dhe studentët rom, ashkalinj dhe egjiptas që e ndiqnin shkollën e mesme dhe universitetin. Deri më sot, Projekti Rajonal për Romët i UNDP-së në Prizren i ka dhënë 26 bursa (24 për nxënësit e shkollave të mesme, dhe 2 për studentët universitarë).

Nxënësit turq të Kosovës fitojnë edukim në turqisht. Planprogrami në gjuhën turke përfshin lëndë "kombëtare" të veçanta për komunitetin, plani mësimor i të cilave është përgatitur nga ekspertët turq të Kosovës. Njëzet deri në tridhjetë përqind të librave të historisë e mbulojnë historinë e komunitetit turk të Kosovës, dhe, po ashtu, edhe atë të Turqisë dhe të ndikimit të saj në Ballkan. Ndërsa tekstet shkollore të bazuara në planprogramin për edukimin fillor janë përgjithësisht në dispozicion, ato që përdoren në

edukimin e mesëm importohen nga Turqia, dhe nuk i referohen Kosovës apo komunitetit turk të Kosovës. Disa nga të intervistuarit ishin të pakënaqur me përfaqësimin e pamjaftueshëm të komunitetit të tyre në kuadër të planprogramit të Kosovës dhe ishin të shqetësuar rreth përfaqësimit të turqve në librat e historisë si okupatorë.<sup>33</sup>

Edhe të intervistuarit boshnjakë të Kosovës ishin të pakënaqur me përfaqësimin e pamjaftueshëm të komunitetit të tyre në planprogramet e Kosovës. Këta studentë e konfirmonin vazhdimisht atë që ata mësojnë mjaft për gjuhën dhe letërsinë boshnjake, por kanë nevojë të mësojnë më tepër rreth historisë së boshnjakëve të Kosovës, domethënë të vetvetes. Mësimdhënësit e gjuhës boshnjake kanë nevojë për përkrahje të mëtejme, sa i përket teksteve shkollore dhe organizimit të aktiviteteve edukative dhe kulturore të cilat do ta forconin motivimin e studentëve, për ta ndihmuar bartjen dhe ruajtjen e identitetit të komunitetit.

Gjuha, historia dhe kultura e komuniteteve të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, nuk janë të përfshira në planprogramin e Kosovës. Prindërit romë në Prizren janë të shqetësuar që fëmijët e tyre nuk mund të flasin apo të mësohen në gjuhën e tyre përtej sferës private, dhe që ata, rrjedhimisht, janë në rrezik të humbjes së trashëgimisë së tyre historike dhe kulturore. Të intervistuarit romë, ashkalinj dhe egjiptas kërkojnë që këto planprograme të plotësohen ashtu që të përfshijnë të dhëna apo lëndë lidhur me kulturën, historinë dhe identitetin e tyre.

Edhe pse komuniteti rom në Prizren ka ndërmarrë nisma të ndryshme që e synojnë zhvillimin e moduleve edukative rreth kulturës, historisë dhe traditave të tyre, të tilla si kërkimi i lëndëve shtesë për gjuhën, kulturën dhe historinë rome, situata megjithatë mbetet e zymtë.

Sipas neneve të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve (Neni 21.1), dhe të Ligjit për të Drejtat e Komuniteteve (Neni 8.10), njësoj si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2007 të Ministrisë së Arsimit për Mësimin në Gjuhën Zgjedhore Zyrtare, në shkollat fillore dhe të mesme apo në lëndët ku gjuha e mësimdhënies nuk është gjuhë zyrtare, nxënësit janë të obliguar ta mësojnë një gjuhë zyrtare sipas zgjedhjes së tyre. Mirëpo, planprogramet e Kosovës në gjuhët boshnjake dhe turke nuk e parashohin gjuhën zyrtare zgjedhore si një lëndë obligative, por një nga lëndët shtesë që prindërit dhe nxënësit mund ta zgjedhin. Prindërit boshnjakë dhe turq të Kosovës e shfrytëzojnë me qëndrueshmëri këtë mundësi dhe kërkojnë që fëmijët e tyre të marrin nga dy lëndë shtesë në javë në gjuhën shqipe. Edukimi i pamjaftueshëm dhe inadekuat në gjuhën shqipe rezulton në mësimin e dobët të kësaj gjuhe njësoj si dhe në mundësitë më të vogla për integrimin edukativ dhe në punësim, dhe kësajsoj kjo nxënësit me gjuhë amtare jo-shqipe

---

<sup>33</sup> Pas një ankese të komunitetit turk të Kosovës, dhe rekomandimeve të Zyres Ndërlidhëse të Republikës së Turqisë në Kosovë, MASHT-i në vitin 2007 i bëri disa ndryshime në planprograme dhe në tekstet shkollore, duke e mundësuar një përfaqësim më objektiv kulturor dhe historik të këtij komuniteti.



i vë në disavantazh. Ashtu siç u theksua nga nxënësit boshnjakë dhe turq të Kosovës në Prizren, ndërkohë që Ministria e Arsimit e ka zhvilluar planprogramin për Gjuhën Shqipe si gjuhë të dytë zgjedhore, tekstet shkollore për këtë lëndë nuk janë shtypur dhe nuk i kanë në dispozicion. Në vend të kësaj, mësuesve dhe nxënësve u jipen tekste shkollore për nxënësit që Gjuhën Shqipe e mësojnë si gjuhë amtare, të cilat për ta janë tejet komplekse kështu që nuk i përdorin në praktikë.

Universiteti i Prishtinës e ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Sarajevës, për krijimin e një qendre edukuese shumëgjuhëshe në qytetin e Prizrenit. Nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje thonë që projekti do t'u mundësojë pakicave lokale në Prizren, qofshin ata turq, boshnjakë apo shqiptarë, të mësojnë së bashku. Kjo do të ishte një fat i mirëfilltë për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm.

## **PUNËSIMI DHE MUNDËSITË E BIZNESIT**

Pronarët e bizneseve në Prizren ankohen që të gjitha dokumentet janë ekskluzivisht në shqip. Formularët për regjistrimin e bizneseve dhe formularët e tatimeve janë vetëm në shqip. Vetëm formulari për tatimin vjetor komunal është në gjuhët shqipe, serbishte dhe turqishte. Ky dokument është përpiluar nga Drejtoria Komunale për Ekonomi dhe Financa e Departamentit për të Hyrat Publike të Komunës së Prizrenit. E tërë procedura për regjistrimin e bizneseve dhe për tatimet është në shqip.

Kompanitë publike PTK dhe KEK nuk lëshojnë fatura apo dokumente të tjera në turqisht. Këto faturat i lëshojnë vetëm në gjuhët shqipe, serbishte dhe anglishte. Faturat e kompanive publike të ujësjellësit dhe për mirëmbajtjen e qytetit, të cilat u ofrojnë shërbimet e tyre qytetarëve të Prizrenit, janë vetëm në shqip. KEK-u, PTK-ja dhe kompanitë e tjera publike nuk i respektojnë rregullat ortografike dhe gramatikore të gjuhës turke kur i faturojnë individët që i takojnë komunitetit turk.

Përfaqësuesit turq besojnë që pjesëtarët e komunitetit turk kanë liri të plotë të lëvizjes dhe që ata janë të integruar në tërësi në shoqërinë kosovare. Ata po ashtu besojnë që turqit kanë qasje të plotë në të gjitha institucionet dhe kompanitë publike të Kosovës. Arsyeja kryesore për integrimin e tyre të suksesshëm në shoqërinë e Kosovës është ajo që pothuajë të gjithë turqit flasin shqip, ndërkohë që edhe një numër i mirë i shqiptarëve flasin turqisht. Megjithatë, përfaqësuesit turq janë të pakënaqur me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Parlamentin e Kosovës dhe nëpër komunat ku gjuha turke është shpallur gjuhë zyrtare (si në rastin e Prizrenit dhe të Gjilanit).

Edhe pse Prizreni është një komunë ku udhëheqësia komunale është duke u përpjekur t'i zbatojë të gjitha dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ky ligj ende nuk zbatohet në tërësi. Shenja komunale ende nuk është edhe në turqisht. Dokumentacioni komunal nuk është i përkthyer në tërësi në turqisht. Turqit rëndom u drejtohen shërbyesve civil në

shqip. Disa përfaqësues të Parlamentit të Kosovës iu janë drejtuar komunës në trajtë të shkruar, por ata përgjigjet i kanë marrë në shqip. Të gjithë përfaqësuesit turq e pranojnë që është e vështirë të gjenden përkthyes të mirë të turqishtes, e cila është arsyeja pse është e vështirë të pritët që i tërë dokumentacioni komunal do të përkthehet për një kohë të arsyeshme.

Përfaqësuesit romë janë para së gjithash të shqetësuar për ruajtjen e identitetit rom. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve nuk zbatohet fare sa i përket popullatës rome. Gjuha rome nuk është gjuhë zyrtare në komunë. Pos kësaj, meqë nuk ka shkolla ku romët mund t'i ndjekin lëndët në gjuhën rome, ata duhet të shkojnë nëpër shkollat që janë, ose nën jurisdikcionin e Qeverisë së Kosovës, ku lëndët mbahen në shqip, ose nën jurisdikcionin e Qeverisë së Serbisë, ku lëndët mbahen në serbisht. Si pasojë, romët janë në rrezik të humbjes së identitetit të tyre kulturor.

Romët e përdorin gjuhën serbe ose shqipe kur flasin me shërbyesit komunal civil. Dokumentet e lëshuara nga institucionet komunale janë, ose në shqip, ose në serbisht, varësisht nga gjuha në të cilën romët e mbushin formularin. Ata e theksojnë që nuk ka individë romë në pozitat e larta në Parlamentin e Kosovës dhe që nuk ka qytetarë romë që punojnë nëpër bankat e Kosovës, në PTK, ose në KEK.

Egjiptasit e kanë lirinë e plotë të lëvizjes. Gjuhë e tyre amtare është shqipja, gjë kjo e cila ju ka mundësuar të integrohen në shoqërinë kosovare më shpejtë se të tjerët. Ata janë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga institucionet komunale, të klinikave për pacientët e jashtëm dhe të kompanive publike në Kosovë. Megjithatë, përfaqësuesit egjiptas besojnë që të gjitha ligjet që janë në interesin e komuniteteve pakicë nuk jetësohen në një mënyrë të kënaqshme.

Papunësia është një problem i veçantë, dhe më i madhi, me të cilin përballen egjiptasit. Shumica dërrmuese e tyre janë të papunë. Përfaqësuesit e egjiptasve në Parlamentin e Kosovës pohojnë që as edhe një egjiptas i vetëm në Pejë nuk punon, as në KEK, dhe as në PTK. Egjiptasit besojnë që komunitetet e tjera etnike në Kosovë janë në një pozitë të privilegjuar krahasuar me ta.

## REKOMANDIMET

- Komuna duhet ta fillojë urgjentisht një fushatë qëllimi i të cilës do të jetë t'i informojë qytetarët e Prizrenit që u takojnë komuniteteve jo-shumicë rreth të drejtave të tyre minoritare dhe rreth të gjitha mekanizmave që i kanë në dispozicion për t'i mbrojtur këto të drejta. Kjo fushatë duhet, po ashtu, t'i përfshijë edhe informatat për të gjithë personat e punësuar në institucionet publike dhe për përgjegjësitë e institucioneve sipas ligjeve që kanë të bëjnë me pakicat.
- Komuna duhet t'i përfshijë në veçanti përfaqësuesit e pakicave në proceset vendim-marrëse rreth çështjeve që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me respektimin e të drejtave të pakicave, të tilla si liria e lëvizjes, e përdorimit të gjuhëve, e arsimit në gjuhën amtare dhe e punësimit.
- Komuna duhet ta përmirësojë nivelin e jetësimit të përdorimit të gjuhëve në administratën komunale dhe në shërbimin civil të komunës.
- Në bashkëpunim me Qeverinë qendrore, Komuna duhet të bëjë përpjekje shtesë, ashtu që ta përmirësojë pozitën e komuniteteve etnike sa i përket të drejtës së pakicave të Kosovës për punësim në ndërmarrjet në pronësi publike, për edukim në gjuhët e pakicave, dhe ta vazhdojë zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) e Kosovës duhet t'i zhvillojë planprogramet për edukim në gjuhën serbe, për nxënësit serbë dhe ata nga pakicat që dojnë të arsimohen në serbisht. MASHT-i duhet po ashtu të shikojë për përmirësimin e mundësive edukative për komunitetet RAE, posaçërisht në fushën e lëndëve të tyre kombëtare.
- MASHT-i i Kosovës duhet t'i furnizojë me tekste shkollore nxënësit e shkollave të larta nga komunitetet jo-shumicë, të cilët i ndjekin planprogramet e Qeverisë së Kosovës. Komuna, në bashkëpunim me MASHT-in mundet po ashtu t'i furnizojë të gjitha tekstet shkollore për shkollat fillore si një motivim shtesë.
- Qeveria Kombëtare dhe autoritetet komunale duhet ta rregullojnë përfaqësimin e pakicave në ndërmarrjet në pronësi publike ashtu që ta sigurojnë, të paktën, përputhshmërinë me vlerësimet etnike. Përqindja e pakicave që punon për kompanitë publike duhet ta pasqyrojë strukturën etnike të rajonit ku vepron kompania përkatëse publike.